GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7438 E hënë 12 Shkurt 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

KORÇA BEER edhe sot me e mira ...

Opinioni i Ditës

Nga DR. SORINA KOTI

Ushqim apo lëmoshë? Shteti përballë biznesit

27 vjet rënie komunizmi dhe Shqipëria ende nuk e ka gjetur rrugën e saj të demokracisë dhe lirisë së tregut. Shqipëria ende ka mbi kokë mentalitetin e qeverisjes...

Vijon në faqen 20

Opinioni i Ditës

Nga SHABAN MURATI

Kushti "kroato-slloven" i BE për Ballkanin Perëndimor

Dy herë brenda një muaji presidenti i Komisionit Europian, Jean-Claude Juncker ka paraqitur një kusht të ri për shtetet e Ballkanit Perëndimor, që duan...

Vijon në faqen 21

Vendi ku ndodhi shpërthimi

Shpërthimi, prokuroria: Kamerat filmuan atentatorët

Tritoli ndaj Kullës, befason Endrit Çopja: Isha në Shkodër për të blerë kanabis

Gjykata lë në "arrest me burg" 3 autorët e dyshuar, pas pamjeve të sekuestruara

Nga SENAD NIKSHIQI

Gjykata e Shkallës së Parë në Shkodër vendosi ditën e djeshme masën e sigurisë "arrest me burg" për dy autorët e dyshuar të atentatit ndaj Lulzim Kullës me 13 janar në Shkodër. Bëhet fjalë për Endri Çopja dhe Argel Lulaj, të cilët dyshohet të jenë autorët...

Në faqen 6

TABELA/SHTATE KATEGORITE QE PERFITOJNE. VELIAJ: ÇIFTET E REJA TE NDJEKIN PROCEDURAT

KREDITE E BUTA, BASHKIA: KRITERET SI TE APLIKONI

Programi rihapet në fund të shkurtit. Prioritet do të kenë familjet e reja, të divorcuarit me fëmijë në ngarkim, të shpronësuarit, por edhe rastet e dhunës

(Në foto) Foto ilustruese

Në faqen 9

DEPUTETI

Arben Pëllumbi: PS, fitore spektakolare në 2019, edhe pse do t'i ketë të gjithë kundër

Në faqet 4-5

DROGA DREJT ITALISË

Qeni zbulon 11 kg heroinë, në kamionin me qese në Durrës, bie në pranga shoferi

Në faqen 7

INTERVISTA

49 vjeçari nga Fieri: Nga pjatalarës, hapa restorantin tim në Kanada, 15 vite emigrim

Në faqen 8

HISTORIA

Absurdi më 1982, Shqipëria i kërkoi Parisit heqjen e portretit të Skënderbeut

Në faqet 18-19

MJEKJA, VLERA LEKAJ: SI TË LUFTONI GRIPIN E TË FTOHURËN

Ylli Merja: Fruthi, si ta kurojmë me bimët medicinale, masat parandaluese

Suplement

EKSKLUZIVE/ Zbulohet dokumenti i shkurtit të 1973, çfarë thanë Pirro Mani, Naim Frashëri, etj.

Letra për Enverin: Diskutimet e aktorëve për ndikimet moderniste

Raporti i Pipi Mitrojorgjit, Sulejman Pitarka tha: Ka shumë kopjime të huaja

Nga DASHNOR KALOÇI

Ky dokument arkivor që po publikojmë në këtë kapitull të këtij libri i përket muajve janar-shkurt të vitit 1973 dhe bën fjalë mbi dy mbledhje të organizatës bazë të partisë të trupës së Teatri Popullor dhe, gjithashtu, kolektivit të

saj, apo siç njihej ndryshe para viteve '90-të, si "organizata e Bashkimeve Profesionale". Këto dy mbledhje konçidojnë me përfundimin e Festivalit të 11 Kombëtar të Këngës në Radio Televizionin Shqiptar, (dhjetor 1972-janar 1973), i cili vetëm pas...

Në faqet 10-11

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

NJOFTIM - SHPALLJE

PËR
HAPJEN E PROÇEDURAVE TË APLIKIMIT PËR VENDIN VAKANT GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 93, 125, 127 pika 1/b, 179 pika 2 dhe 12 të Kushtetutës, si dhe të neneve 7, 7/a, 7/b, 86 pika 4 shkronja "a", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe referuar shkresës nr. 101 prot, datë 25.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilën njoftohet se data 25.04.2016, konsiderohet si datë e mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarit Sokol Berberi, me cilësinë e organit të emërtesës dhe me qëllim plotësimin e "**Vakancës së parë",** të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, me **Dekretin nr. 10722, datë 07.02.2018,** ka miratuar;

- Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërim gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me qëllim plotësimin e **"Vakancës së parë"** të krijuar për shkak të përfundimit të mandatit të ish-gjyqtarit të kësaj gjykate **Z. Sokol Berberi**.

Presidenti i Republikës fton;

Çdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kushtetutën e vendit dhe nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të marrë pjesë në këtë procedurë të konkurrimit të hapur publik, për vakancën e mësipërme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës;

- Kërkesën për shpehjen e interesit për të kandiduar për vendin vakant të shpallur;
- Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit *(numër telefoni/email);*
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dokumentacionin shoqërues nëpërmjet të cilit vërteton përmbushjen e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Formularin e vetëdeklarimit të plotësur dhe nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Formulari i vetëdeklarimit, është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.
- Formularin e aplikimit të plotësuar "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e Ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", formular ky i cili është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.

Për lehtësinë e të gjithë aplikantëve, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, më poshtë gjeni të botuar përmbajtjen e nenit 125, pika 4 e 5 të Kushtetutës dhe nenit 7/a, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku parashikohen kushtet dhe kriteret për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese,

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**

Neni 125

4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.

- **Ligji nr.8577, dt 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.**

Neni 7/a
Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:
a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;
c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;
d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:
a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
b) të ketë një veprimtari në njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kritereve të mësipërme vlerësohet në bazë të:
a) vjetërsisë në profesion;
b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë;
c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;
ç) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;
d) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimit përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;
dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.
4. Organet e emërtesës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjinore.

Kërkesa dhe dokumentat shoqëruese mund të dorëzohet me postë ose drejpërsëdrejti në ambjentet e Presidencës, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1 Tiranë, Kodi Postar 1001.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm, është brenda datës 22 shkurt 2018.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e aplikantëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës dhe me mjetet e informimit publik, dhe menjëherë dosjet respektive për secilin aplikant do t'i përcillen Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për vlerësim sipas ligjit.

Institucioni i Presidentit të Republikës, do të bëjë transparente çdo rezultat të këtij procesi në përputhje me Kushtetutën dhe procedurën e parashikuar në nenin 7/b, të ligjit nr.8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Për çdo sqarim mos hezitoni të kontaktoni në këto të dhëna kontakti:
Numri telefonit: ***042389898***

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

NJOFTIM - SHPALLJE

PËR
HAPJEN E PROÇEDURAVE TË APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E "VAKANCËS SË PARAKOHSHME" TË KRIJUAR PËR VENDIN GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 93, 125, 127 pikat 1/c, 2, 3, dhe nenit 179 pika 2 të Kushtetutës, neneve 7 pika 2, 7/a, 7/b, 7/dh pika 2, 86 pika 4 shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 2, datë 31.01.2018 të Gjykatës Kushtetuese për "Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Besnik Imeraj në datën 31.01.2018, për shkak të heqjes dorë prej tij", njoftuar me shkresë nr. 64/1 prot, datë 31.01.2018, me qëllim plotësimin e "**Vakancës së pararakoshme",** të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, dhe me cilësinë e organit të emërtesës me **Dekretin nr. 10723, datë 07.02.2018,** ka miratuar;

- Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërim gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për plotësimin e **"Vakancës së parakohshme"** të krijuar nga përfundimi përpara kohe i mandatit, të ish-gjyqtarit **Z. Besnik Imeraj,** më datë 31.01.2018, për shkak të heqjes dorë prej tij nga kjo detyrë.

Presidenti i Republikës fton;

Çdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kushtetutën e vendit dhe nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të marrë pjesë në këtë procedurë të konkurrimit të hapur publik, për vakancën e mësipërme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës;

- Kërkesën për shpehjen e interesit për të kandiduar për vendin vakant të shpallur;
- Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit *(numër telefoni/email);*
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dokumentacionin shoqërues nëpërmjet të cilit vërteton përmbushjen e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Formularin e vetëdeklarimit të plotësur dhe nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Formulari i vetëdeklarimit, është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.
- Formularin e aplikimit të plotësuar "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e Ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", formular ky i cili është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.

Për lehtësinë e të gjithë aplikantëve, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, më poshtë gjeni të botuar përmbajtjen e nenit 125, pika 4 e 5 të Kushtetutës dhe nenit 7/a, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku parashikohen kushtet dhe kriteret për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese,

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**

Neni 125

4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.

- **Ligji nr.8577, dt 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.**

Neni 7/a
Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:
a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;
c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;
d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:
a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kritereve të mësipërme vlerësohet në bazë të:
a) vjetërsisë në profesion;
b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë;
c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;
ç) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;
d) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimit përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;
dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.
4. Organet e emërtesës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjinore.

Kërkesa dhe dokumentat shoqëruese mund të dorëzohet me postë ose drejpërsëdrejti në ambjentet e Presidencës, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1 Tiranë, Kodi Postar 1001.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm, është brenda datës 22 shkurt 2018.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e aplikantëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës dhe me mjetet e informimit publik, dhe menjëherë dosjet respektive për secilin aplikant do t'i përcillen Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për vlerësim sipas ligjit.

Institucioni i Presidentit të Republikës, do të bëjë transparente çdo rezultat të këtij procesi në përputhje me Kushtetutën dhe procedurën e parashikuar në nenin 7/b, të ligjit nr.8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Sqarim:

Në zbatim të nenit 127 pika 3 të Kushtetutës, dhe nenit 7/dh pika 2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për oganizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, kandidati që do të përzgjidhet për tu emëruar gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, për plotësimin e vakancës së parakohshme të krijuar për shkak të përfundimit përpara kohe të mandatit ish-gjyqtarit Bensik Imeraj, do të qëndrojë në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar.

Për çdo sqarim mos hezitoni të kontaktoni në këto të dhëna kontakti:
Numri telefonit: ***042389898***

RAPORTI NE KUVEND

INTEGRIMI

Dokumenti me 23 faqe, qeveria: U rrit sasia e hashashit të sekuestruar

Raporti i MEJP në Kuvend: Pakti Rama-Basha, pozitiv për integrimin

"Besojmë në hapjen e negociatave, kemi vlerësime nga BE"

Ministria për Eu ropën dhe Punët e Jashtme ka dorëzuar në Kuvend raportin për vitin 2017 mbi ecurinë e procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në këtë raport theksohet se vetingu është pika kyçe për hapjen e negociatave, ndërsa vlerësohet marrëveshja e 18 majit, mes kryeministrit Rama e kreut të PD-së, Lulzim Basha para zgjedhjeve të përgjithshme. "Marrëveshja e 18 majit, frymë pozitive për integrimin. 17 projektligje për t'u ndryshuar për përafrim me BE", thuhet më tej në raport. Sa i përket institucioneve ka pasur vlerësim pozitiv nga BE, dhe se vijon akoma të ketë hapësira për të plotësuar nga i gjithë procesi i çeljes së negociatave. 'Asgjësuam 933.014 bimë narkotike në 2754 parcela, gjatë 2017 asgjësuam 1.722.789 bimë më pak se në vitin 2016",-thuhet në raportin e qeverisë. Në nisje të raportit thuhet se për hapjen e negociatave "një hap kyç në këtë drejtim është reforma në drejtësi, e cila është një nga reformat më të thella që është ndërmarrë ndonjëherë në vendet kandidate për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian". "Ecja e shpejtë në plotësimin e hapave të Reformës në Drejtësi, rivlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve, plotësimi i reformës në drejtësi me masa shtesë si vetingu i trupës policore, janë vendimtare për hapjen e negociatave të anëtarësimit", vijon raporti prej 23 faqesh. "Besimi ynë në arritjen e objektivit të hapjes së negociatave bazohet në vlerësimet pozitive të marra nga institucionet e Bashkimit Evropian, përfshi vlerësimet e përfaqësueses së lartë të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, në takimin e 9-të të Këshillit të Stabilizim-Asociimit, se Shqipëria ka bërë përparim të mëtejshëm domethënës që nga rekomandimi i Komisionit Evropian i vitit 2016",-shprehet ministri i Jashtëm. "Në kontekstin e dialogut politik me institucionet e BE dhe me vendet anëtare, veprimi ynë diplomatik është përqendruar në vënien në dukje të masave për zbatimin e prioriteteve për hapjen e negociatave të anëtarësimit dhe bashkërendimin e tyre me vendet anëtare dhe Komisionin Evropian",-vijon raporti. Në dokumentin e dorëzuar në Kuvend përmenden takimet që janë zhvilluar për këtë çështje me Komisionin Evropian apo drejtues të BE-së. "Në tërësi, Shqipëria i ka përmbushur detyrimet e saj në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Takimet e institucioneve të përbashkëta Shqipëri - Bashkimi Evropian janë zhvilluar rregullisht dhe është paraqitur tashmë raportimi i parë si pjesë e procesit të hartimit të Raportit të Komisionit për vitin 2018", -citon raporti.

Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati

SALI BERISHA

Ish-kryeministri Sali Berisha deklaroi dje, se kryeministri Rama shpërndau përmes mediave se Greqia i kishte falur Shqipërisë blloqet 1 dhe 2 dhe shumë territore të tjera. Sipas Berishës kjo "provon se Edvin Kristaq Rama ka arritur marrëveshjen e Detit me Greqinë dhe, siç kemi njoftuar javë më parë dhe konfirmuar disa herë publikisht nga pala greke, ai ka kapitulluar dhe falur fushat më të mëdha të gazit dhe naftës në Jon dhe Mesdhe".

Oerd Bylykbashi: Rama u shiti territorin grekëve

Pakti detar, Presidenca: Nuk na kanë kërkuar plotfuqishmëri për negociatat

Pas deklaratës se ishpresidenti Bujar Nishani se "deri më 24 korrik 2017 në Institucionin e Presidentit të Republikës nuk është paraqitur asnjë kërkesë nga qeveria për "Plotfuqishmërinë" lidhur me negociatorët për marrëveshjen e detit", ka reaguar edhe pasardhësi i tij Ilir Meta. Burime nga Presidenca konfirmuan për mediat se deri tani nuk është kërkuar asnjë plotfuqishmëri për negociatat e marrëveshjes së detit me Greqinë. Ish-Presidenti Nishani, duke iu referuar mediave greke tha një ditë më parë se marrëveshja e detit mes Shqipërisë dhe Greqisë është arritur dhe territoret zyrtare shqiptare i kanë kaluar shtetit helen. Sipas Nishanit nëse kjo është e vërtetë, atëherë do nisë një konflikt i ri mes dy vendeve me pasoja rajonale. Ai bëri thirrje Arta Markut të ndërhyjë. Nga ana tjetër, deputeti i PD-së, Oerd Bylykbashi akuzoi dje, kryeministrin Edi Rama se po bllokon Gjykatën Kushtetuese për të kryer shitjen e detit, Greqisë. "Rama i ka shitur territorin e Shqipërisë? grekëve! Tregtari i kufijve ka bërë marrëveshje në fshehtësi dhe në shkelje të Kushtetutës. Askush nuk di çfarë interesi tjetër kombëtar ka tregtuar për pushtetin e tij",-u shpreh Bylykbashi. Sipas tij, "Gjykata Kushtetuese është në kolaps. Nuk merr dot vendime. Nga 9 anëtarë, vetëm 5 janë sot në detyrë me mandat të plotë. Rama po bllokon zëvendësimin e vendeve bosh. ? A mos vallë Rama e bllokon Gjykatën Kushtetuese që në këtë Rrëmujë të Drejtësisë të bëjë fakt të kryer shitjen e detit dhe Gjykata të mos e anulojë marrëveshjen??",-shkroi dje, Bylykbashi, në një koment në rrjetin social, "FB". "Sa herë Rama bën ndonjë zullum e quan reformë. Shihni kur ta quajë këtë reforma e detit. Kësaj radhe ata që do duartrokasin do të jenë në Athinë",-

Presidenti Ilir Meta

LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

"Zhvillimet legjislative në luftën kundër korrupsionit përfshijnë miratimin e amendamenteve në Kodin e Procedurës Penale, si dhe të ligjit për institucionet që luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar, përmes së cilave vendoset krijimi i: një Prokurorie të specializuar, një Njësie Hetimi të pavarur, një Gjykate të specializuar. Ka vijuar trendi pozitiv drejt një bilanci të qëndrueshëm rezultatesh hetimi, ndjekjeje penale dhe dënimi të rasteve të korrupsionit, siç dëshmohet ndër të tjera nga rritja me 8.2% në numrin e rasteve të referuara në prokurori nga policia në 6 mujorin e parë të 2017, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës",-citon raporti.

LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

"Në luftën kundër kultivimit të narkotikëve, në periudhën shtator 2016 - shtator 2017, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, u shënua një rritje masive prej 73.459 kg në sasinë e marijuanës/kanabisit të sekuestruar. Lufta kundër kultivimit të kanabisit vijoi me një ritëm të qëndrueshëm, me asgjësimin e 933.014 bimëve narkotike në 2754 parcela, në periudhën shtator 2016 - shtator 2017. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënia me 1.722.789 në numrin e bimëve narkotike të asgjësuara dhe me 3476 në numrin e parcelave të identifikuara, është rezultat i reduktimit në nivele domethënëse të kultivimit të kanabisit. Rezultatet në identifikimin dhe asgjësimin e bimëve narkotike ishin gjithashtu pasojë e bashkëpunimit të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, përfshi misionet e fluturimit me Guardia di Finanza të Italisë. Ka vijuar trendi pozitiv drejt një bilanci të qëndrueshëm rezultatesh hetimi, ndjekjeje penale dhe dënimi të rasteve të krimit të organizuar dhe krimit të rëndë. Në 6 mujorin e parë të 2017 u rrit me 25.3% numri i rasteve të dërguara në prokurori nga policia, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Shtyu vizitën Avramopulos sot, në Tiranë, pakt për kontrollin kufitar

Së shpejti në kufirin shqiptar vendoset roja kufitare dhe evropiane bregdetare. Komisioneri për Migrimin dhe Punët e Brendshme, Dimitris Avramopulos do të nënshkruajë marrëveshjen mes policisë shqiptare dhe Frontex, Agjensisë së BE-së përgjegjëse për mbikëqyrjen e kufijve tokësorë e detarë të zonës europiane Shengen, në koordinim me vendet anëtarë të zonës Shengen. Komisioneri Avramopulos do të jetë në delegacion më një grup ekspertesh të Frontex, me të cilët pritet të zyrtarizohet bashkëpunimi e që do mbështesin palën shqiptare me logjistikë dhe trajnime. Në një intervistë për Javanews, Avramopulos tha se kjo do të sigurojë një menaxhim më të mirë të migracionit të parregullt drejt BE-së. "Marrëveshja do të lejojë vendosjen në Shqipëri të ekipeve evropiane të Kufirit dhe Rojës Bregdetare me kompetenca ekzekutive. Kjo do të sigurojë një menaxhim më të mirë të migracionit të parregullt, që përbën interesin tonë të përbashkët",-tha ai.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu***: Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës
së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu***: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

SITUATA POLITIKE
INTERVISTA

Deputeti socialist: Zhvillimi i vendit nuk mund të jetë tekë e askujt

Arben Pëllumbi: PS, fitore spektakolare në 2019 edhe pse do i ketë të gjithë kundër

"Rruga drejt Evropës kërkon punë dhe bashkëpunim"

Gjatë një seance parlamentare

Darina Tanushi

Deputeti socialist, Arben Pëllumbi vlerë son se kjo qeveri e ka rrëzuar mitin e krijuar se qeveritë në mandatin e tyre të dytë nuk punojnë siç duhet. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", ai shprehet se nuk është penduar që i ka hyrë rrugës së politikës, edhe pse njohjet me të, për shkak të prejardhjes i ka të hershme. Por, ai mbetet kritik me mënyrën e si po e ushtron detyrën e saj opozita.

"Në një shoqëri me demokraci të vërtetë funksionale palët kërkojnë konsensus kur është e mundur, por në asnjë mënyrë minoranca nuk mund t'i imponohet maxhorancës e ca më pak ta bëjë këtë nga pozitat e dhunës e forcës",-u shpreh Pëllumbi. Ai shprehet se PS do të ketë një fitore spektakolare në zgjedhjet vendore të 2019-tës, pavarësisht se këtë herë do t'i ketë të gjithë kundër.

Deputeti socialist, Arben Pëllumbi

Z.Pëllumbi, meqenëse u bënë muaj që jeni pjesë e Kuvendit të Shqipërisë, si i shihni zhvillimet brenda tij, veçanërisht gjatë seancave të ditëve të enjte?

Legjislatura e IX e Kuvendit të Shqipërisë është tashmë në sesionin e dytë dhe gjatë kësaj periudhe ka pasur zhvillime të ndryshme si pozitive dhe negative. Sigurisht publiku njihet me këto zhvillime gjatë seancave të të enjtes, por puna e vërtetë është ajo që bëhet në komisionet e përhershme parlamentare, të cilët përgatisin materialet që do të diskutohen e votohen. E për sa i përket seancave plenare do të veçoja si shumë pozitiv impenjimin e kryetarit të Kuvendit, z.Ruci, por edhe të tjerëve, për të kthyer në binaret e rregullores punimet e seancës dhe veçanërisht zbatimin me përpikmëri të orarit të fillimit, kohës në dispozicion por edhe qëllimit për të cilën kërkohet fjala. Jo pak herë ky qëndrim korrekt është shfrytëzuar me arrogancë nga opozita për të realizuar skenarë imponues, nganjëherë dhe të turpshëm. Megjithatë, maxhoranca, në ushtrim të detyrimeve të saj kushtetuese ka vijuar aprovimin e projektligjeve, (në rastin e marrëveshjeve ndërkombëtare ka pasur dhe konsensus), duke siguruar një vijim normal të punimeve të Kuvendit. Dua të theksoj këtu që seanca e fundit përmbylli edhe pse pa konsensus, detyrimin kushtetues të Kuvendit në lidhje me organet e reja të drejtësisë. Uroj që seanca të shëmtuara si ajo e 18 dhjetorit me tymuese, çizme e çdo gjë tjetër që fluturonte në ajër, të ngelen një kujtim i largët. Në një shoqëri me demokraci të vërtetë funksionale palët kërkojnë konsensus kur është e mundur, por në asnjë mënyrë minoranca nuk mund t'i imponohet maxhorancës e ca më pak ta bëjë këtë nga pozitat e dhunës e forcës. Gjithsesi bëj pjesë tek ata që besojnë me optimizëm tek një legjislaturë brenda normales.

A jeni penduar që jeni bërë pjesë e politikës?

Unë vërtetë vij nga fusha e biznesit, por nuk është se nuk e dija çfarë përfaqëson dhe çfarë problematikash ka politika jonë sot. Edhe për shkak të prejardhjes familjare kam pasur dhe kam njohje personale pothuaj me të gjithë aktorët e rëndësishëm në jetën politike të vendit dhe më gjerë. Për këto arsye, nuk kam pasur surpriza, prandaj JO, nuk jam penduar edhe sepse qëllimi për të cilin jam sot pjesë e politikës, siç është pastrimi, civilizimi dhe vënia e interesit kombëtar mbi atë partiak e personal tashmë ka filluar.

A mundet të na bëni një analizë të shkurtër si po qeveris në këtë mandat të dytë qeveria "RAMA"?

Në përgjithësi dhe veçanërisht në Shqipëri, mandatet e dyta nuk rezultojnë shumë pozitivë. Por unë jam i prirë të shikoj një ndryshim të madh tek qeveria "RAMA 2", prirje që mbështetet tek vizioni reformator dhe energjitë e shumta që Kryeministri i jep drejtimit qeverisës. Dua të kujtoj që, në mandatin e parë u bënë një sërë reformash ku do të veçoja atë territoriale, në arsim e atë në sektorin e energjisë, duke kulmuar me reformën në sistemin e drejtësisë. Kjo reformë është edhe në këtë mandat të dytë një target i rëndësishëm që duhet përmbyllur dhe të fillojë të japë frytet e para, të cilat do të ndikojnë në mënyrë të pashmangshme edhe në ekonomi, përparimi i të cilës është në esencë qëllimi final i çdo qeverie. Dhe në vazhdim të këtij mendimi dëshiroj të rikujtoj që viti 2017 edhe pse vit zgjedhor, u mbyll me një rritje ekonomike të rëndësishme që pritet të jetë rreth 4%, me ulje të borxhit publik e papunësisë, e me stabilitet makroekonomik. Thënë këto, qeveria edhe për të ndryshuar historinë e mandateve të dyta, vazhdon të ndërmarrë reforma të reja të guximshme, si p.sh. ajo administrative, duke bërë ndryshime të rëndësishme jo aq në koncepti ministerial se sa në atë të agjencive dhe inspektorateve me fokus uljen e korrupsionit dhe rritjen e shërbimeve, duke çuar në zvogëlimin e një numri të madh dokumentesh që duhen paraqitur, por dhe printimin online të një numri të madh syresh si dhe zvogëlimin në minimum të lejeve e licencave që duhen për kryerjen e një aktiviteti ekonomik. Në bashkërendim kjo edhe me kohën minimale e vlerën e papërfillshme monetare që duhet për të hapur një aktivitet ekonomik, po e bën Shqipërinë një vend që ofron lehtësim në rritje të të bërit biznes. Sigurisht si në çdo vend edhe tek ne ka biznese që hapen, por ka dhe që mbyllen. E rëndësishme është që numri i bizneseve të reja të jetë dhe është disa herë më i madh.

> **INTEGRIMI**
>
> "Duhet të bindemi njëherë e mirë se këtë vend nuk do ta bëjnë të huajt, por ne. Rruga drejt Europës nuk do të thotë më shumë lekë qyl e pa punuar, kafe e aheng, sidomos brezi i ri, por përkundrazi më shumë mundësi për punë e impenjime ndaj vetes dhe të tjerëve".

Gjithashtu, një luftë në rritje do të vazhdojë kundër informalitetit në ekonomi dhe këtu do të ketë një ndikim të ndjeshëm dhe ulja e tavanit në 2 milionë për bizneset që do të deklarojnë TVSh-në, duke qenë të kujdesshëm që kjo të mos sjellë rritje kostosh për bizneset vërtet të vogla.

Një ndihmesë të madhe po jep në këtë drejtim dhe platforma e bashkëqeverisjes si një mjet i drejtpërdrejtë për të shkundur institucionet në respekt të qytetarit. Sigurisht nuk them që çdo gjë po funksionon siç duhet, ka akoma shumë për të bërë. E dimë mjaft mirë që Shqipëria dhe shqiptarët kanë shumë probleme e halle. Vazhdojmë të jemi nga vendet më të varfra në Evropë, sigurisht politika ka gjynahet e veta në këto 27 vite, por dhe mentaliteti i vjetër që shumica presin çdo gjë nga shteti dhe mospërshtatjen me sistemin kapitalist, ia faturojnë për lehtësi qeverisjes, duhet të ndryshojë. Shkatërrojmë e rrënojmë pronën e përbashkët, përpiqemi të zgjidhim hallet tona duke përdorur një mik, një politikan ose më keq akoma me lek në dorë e duke mos kuptuar që shkaku i vërtetë i gjendjes në të cilën ndodhemi jemi vetë ne, jemi ne administrata, jemi ne politika, jemi ne qeveria, askush nuk ka ardhur nga Marsi. Duhet të bindemi njëherë e mirë se këtë vend nuk do ta bëjnë të huajt, por ne. Rruga drejt Europës nuk do të thotë më shumë lekë qyl e pa punuar, kafe e aheng, sidomos brezi i ri, por përkundrazi më shumë mundësi për punë e impenjime ndaj vetes dhe të tjerëve, më shumë iniciativë e bashkëpunim dhe mos harrojmë më shumë dashuri për Atdheun.

Jeni duke u përgatitur për zgjedhjet vendore dhe tashmë puna ka nisur brenda degëve të PS-së. A mendoni se do të përsëritet fitorja e qershorit të 2017?

Ne si Parti Socialiste, në bazë të statutit tone, kemi përmbyllur zgjedhjet e reja në organizata në shkallë vendi duke reflektuar rezultatet e 25 qershorit 2017 dhe sigurisht që objektivi politik i radhës janë zgjedhjet lokale të vitit 2019. Ne besojmë që me punën që po bëhet nga të zgjedhurit tanë lokalë dhe sidomos nga pushteti qendror, siç e theksova dhe më lart, me politikën e tepsisë për skrap, por dhe nga kontaktet personale që kam me njerëzit, dhe jo vetëm në zonat e Farkës, Pezës e Ndroqit që përfaqësojë, por edhe në zona të tjera ku nuk kanë munguar kontaktet, si rezultat i procesit të bashkëqeverisjes edhe pse në këto zgjedhje do të kemi të gjithë kundër PS-së, rezultatet do vazhdojnë të jenë spektakolare për ne. Përpos gjithë zhurmës që bëhet votuesit kanë ditur dhe do të dinë të orientohen drejt, drejt njerëzve të punës dhe rezultateve.

Të enjten ju miratuat në Kuvend anëtarët e dy prej institucioneve më të rëndësishme të drejtësisë, KLP e KLGJ, por pa votën e opozitës. A e dëmton kjo këtë proces që në

➔

fakt kërkon një konsensus të gjerë?

Po, ashtu është, Kuvendi përmbylli para disa ditësh detyrimin e tij kushtetues për plotësimin e organeve të reja të drejtësisë, një proces ky që i jepte mundësinë edhe opozitës të kontribuonte, por që tashmë e dinë të gjithë, ajo refuzon bashkëpunimin me qëllimin e vetëm bllokimin e reformës në drejtësi, reformë që u inicua prej nesh, u mbështet fuqimisht po prej nesh, por dhe pse u votua me konsensus të gjerë, nuk duhet të harrojmë se si u detyruan gjithë të tjerët, nga një ndërhyrje e fortë ndërkombëtare, të ngrenë kartonin lart e kokën poshtë. Mirë do të ishte të kishte konsensus, por kushtetuta e ka përcaktuar qartë dhe ka sanksionuar procedurat zhbllokuese, sepse në fund të fundit, reformat dhe zhvillimi i vendit nuk mund dhe nuk duhet të jenë tekë e askujt, sado i rëndësishëm të jetë apo të ketë qenë.

Opozita ka lajmëruar protesta të tjera si ajo e datës 27 janar. A prishin stabilitetin në vend protestat dhe sa dëmtojnë imazhin e Shqipërisë që pret hapjen e negociatave me BE në muajt në vijim?

Më lejoni fillimisht të bëj një analizë të shkurtër në vazhdim të pyetjes suaj. Në 27 janar opozita organizoi një tubim politik ,jo një protestë, sepse si rregull protestat nuk organizohen nga partitë politike, ato mund t'ju bashkëngjiten atyre. Në këtë kuptim që një segment i caktuar i shoqërisë të mund të protestojë duhet të ketë arsye të forta, që qeveria nuk po i dëgjon. Mua nuk më rezulton që qeveria të ketë lënë pas dore ndonjë problem të tillë, pavarësisht se jo gjithmonë është e mundur gjetja e zgjidhjes. Prandaj nuk shikoj bazë reale për protesta. Sigurisht mund të kemi tubime të tjera opozitare, por kemi vetëm pak muaj nga zgjedhjet politike dhe elektorati foli qartë. Justifikimet për vjedhje vote kur opozita kishte 6 ministra dhe kontroll të të gjitha ndërmarrjeve të rëndësishme në vend, kishte kreun e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, komisionerë e vëzhgues kudo, e nuk dokumentoi një shkelje të vetme apo kontestoi një rezultat, mbeten justifikime foshnjarake. Tubimet opozitare që si qëllim të fshehur apo të dukshëm kishin bllokimin e reformës në drejtësi, tani nuk vlejnë, sepse nuk mund ta ndalin dot më atë. Edhe krijimi i një opinioni që në Shqipëri situata politike nuk është e qëndrueshme, për të penguar hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian, pas publikimit të strategjisë së re të zgjerimit, nuk prodhon më asgjë. Gjithashtu, nuk duhet të harrojmë dhe problemet e brendshme të lidershipit të Partisë Demokratike, probleme që sipas meje do të thellohen. Nuk përjashtoj as mundësinë që të kërkohet një lider apo lidere e re që mund të përfaqësojë më mirë "trashëgiminë" e z.Berisha në PD. Thënë të gjitha këto personalisht nuk besoj që rruga e tubimeve do të ishte një zgjedhje e mençur për opozitën. Gjithsesi, protestat dhe tubimet si një mjet demokratik për të shprehur kundërshtime, kur organizohen brenda kuadrit ligjor, nuk besoj se sjellin prishje të imazhit të vendit e, gjithashtu, kanë filluar të ndikojnë gjithmonë e më pak në ekonomi. Për ta mbyllur bindja ime është që Shqipëria do t'i hapë negociatat me BE-në dhe viti 2018 do të jetë një vit përgjithësisht pozitiv për të gjithë ne.

Faleminderit

Kreu i Grupit të PD: Procesi i tenderimit ngre hije dyshimi

Koncesionet e inceneratorëve, PD kërkon në interpelancë Gjiknurin

"Kompania fituese mori 5.2 mln euro për mbetjet në Fier"

Partia Demokratike kërkon interpelancë me ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjiknuri. Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Edmond Spaho i ka dorëzuar Kryetarit të Kuvendit, Gramoz Ruçi, një kërkesë për interpelancë urgjente me ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjiknuri, si pikë e parë e rendit të ditës së seancës plenare të 14 shkurtit. Interpelanca në emër të grupit parlamentar të PD-së, siç theksohet në kërkesë, do të zhvillohet nga deputetja Jorida Tabaku, e kërkohet për të raportuar në lidhje me informacionet zyrtare të koncesioneve të inceneratorëve Elbasan, Fier dhe Tiranë. Në kërkesën drejtuar Ruçit thuhet: "Politika e ndjekur nga qeveria e Shqipërisë në lidhje me koncesionet ka qenë e mbuluar vitet e fundit me hije dyshimi të lidhjeve personale mes anëtarëve të qeverisë dhe bizneseve përfituese. Aq të forta kanë qenë këto lidhje, sa që jo rrallë herë edhe e mira publike dhe shëndeti i shqiptarëve është vendosur, e vazhdon të vendoset, në rrezik prej këtyre koncesioneve. Muajt e fundit, Partia Demokratike, mediat dhe pjesëtarë të shoqërisë civile kanë bërë publike një sërë dokumentesh që ngrenë hije dyshimi mbi koncesionet e dhëna nga qeveria për inceneratorin e Elbasanit, Fierit dhe Tiranës". "Mënyra se si janë zhvilluar proceset e tenderimit dhe dhënies së koncesioneve si dhe lidhjet e kompanive fituese, ngrenë hije të mëdha dyshimi për ligjshmërinë dhe menaxhimin e tyre dhe lidhjen me politikën e qeverinë", thuhet në kërkesë. "Përpara disa javësh kryetari i opozitës si dhe deputetë të tjerë kanë denoncuar këto veprime arbitrare që janë tërësisht të paligjshme dhe që ndikojnë në shëndetin e qytetarëve, por edhe në buxhetin e shtetit. Konkretisht, rezulton se një individ i vetëm i ndërlidhur me disa kompani në mënyrë të tërthortë apo të dukshme ka qenë përfituesi i vetëm i tre inceneratorëve. Gjithashtu, vërehet se praktika e ndjekur nga qeveria për dhënien e koncesionit në fjalë është abuzive, pasi është kompania e krijuar pak ditë përpara fitimit të këtij koncesioni që ka paraqitur një propozim të pa kërkuar, dhe kompania nuk ka asnjë kontratë të ngjashme në këtë sektor. Duke ngritur kësisoj hije dyshimi mbi mënyrën e dhënies së tij", thuhet në kërkesë. Sipas Spahos, "njëra prej kompanive që ka fituar koncesionin e inceneratorëve është e regjistruar në Parajsat Fiskale të Vendeve të Ulëta (Holandës) duke shtuar edhe më dyshimin për një aferë korruptive që do të ketë pasoja të rënda jo veç në financat e buxhetit të shtetit, por edhe në shëndetin e shqiptarëve". Sipas PD-së, "sot, kompania që ka fituar në mënyrë të dyshimtë koncesionin e inceneratorëve ka përfituar nga buxheti i shtetit 5.2 milionë euro për impiantin e mbetjeve në Fier, ndonëse ky i fundit nuk ka nisur akoma punën e banorët janë në protestë". Duke kritikuar qeverinë për mosreagim, në kërkesë thuhet: "Në vlerësimin tonë, është detyrë e Kryeministrit dhe Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit së një vendi kandidat për në Bashkimin Europian, që të analizojë me përgjegjshmëri këto fakte tronditëse, si dhe të mbajë qëndrim publik dhe mbi të gjitha të bëjë transparente për kuvendin dhe publikun kushtet në të cilat janë zhvilluar procedurat dhe si janë lidhur e termat e kontratave".

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Edmond Spaho

DENONCIMI

PD denoncoi dje, përmes kreut të Departamentit të Mjedisit në parti, Jamarbër Malltezi, atë që e konsideron si teatrin e luajtur prej kryeministrit Rama dhe ministrit Blendi Klosi, sa i përket ndërtimit të HEC-eve në kanionet e Osumit. Sipas tij, Rama ka qenë në dijeni të projektit, pasi ishte informuar nga Meta.

Vasili: për fajin e Ramës, Shqipëria u dënua 70 mln euro nga gjykatat ndërkombëtare

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili publikoi dje, shkresat zyrtare që i kishte dërguar kryeministrit Edi Rama në kohën që ishte ministër i Drejtësisë, me të cilat, sipas tij, e kishte paralajmëruar për rrezikun financiar që i kanosej vendit. "Pata paralajmëruar kryeministrin: 2 miliardë euro dhe ja, erdhi dënimi i parë 70 milionë euro. Pata paralajmëruar disa herë se rrezikohet të humbasë deri në 2 miliardë euro Shqipëria në gjyqet ndërkombëtare. Si ministër i Drejtësisë në atë kohë, kryeministrin e kam informuar me shkrim për emergjencën e jashtëzakonshme financiare, që kërcënonte financat e Shqipërisë",-shkroi dje, Vasili. "Për fajin e kryeministrit brenda tre javësh Shqipëria u dënua me më shumë se 70 milionë euro nga gjykatat ndërkombëtare. Po jua përsëris është emergjencë financiare e frikshme dhe mbi kryeministrin rëndon përgjegjësia kriminale edhe veprimeve shkatërrimtare financiare të tij me prishjen e njëanshme të kontratave, por edhe mosveprimeve të tij, pasi edhe pse u informua me shkrim për situatën, nuk lëvizi as gishtin dhe nuk bëri asgjë",-tha kreu i Grupit të LSI-së. "Me 70 milionë eurot vetëm sa ka filluar të konsumohet kjo tragjedi për shqiptarët",-tha ai.

Paloka: Prokuroria të hetojë dy ministrat e Ramës, flitet për para

Nënkryetari demokrat i Kuvendit, Edi Paloka ka kërkuar nga Prokuroria e Përgjithshme të japë sqarime nëse zotëron përgjime të dy ministrave Ahmetaj dhe Gjiknuri në komunikime me personazhe, të cilat i implikojnë këta dy ministra në afera kriminale dhe korruptive. Në këto përgjime flitet, sipas tij për para dhe zgjedhjet. "Pas Sajmir Tahirit, këta dy ministra, njihen si dora e Ramës në aferat e tij më të zeza. Jo më kot për këta të dy u krijuan dhe dy super-ministritë, të cilat praktikisht përmbledhin shumicën absolute të fondeve të gjithë qeverisë. Informacione mbi ekzisten-cën e përgjimeve të këtyre ministrave vijnë dhe nga burime të tjera. Prokuroria duhet patjetër të reagojë e të prononcohet nëse janë apo jo të vërteta çfarë ngrihet nga mediat dhe pse nuk veprohet"- pyet deputeti demokrat, Edi Paloka.

Shpërthimi me 8 të plagosur, prokuroria: Kamerat e sigurisë kanë filmuar atentatorët

Tritoli ndaj Kullës, befason Endrit Çopja: Isha në Shkodër për të blerë kanabis

Gjykata e Shkodrës le në burg 3 autorët e dyshuar

Senad Nikshiqi

SHKODER

Gjykata e Shkallës së Parë në Shkodër ven dosi ditën e djeshme masën e sigurisë "arrest me burg" për dy autorët e dyshuar të atentatit ndaj Lulzim Kullës me 13 janar në Shkodër. Bëhet fjalë për Endri Çopja dhe Argel Lulaj, të cilët dyshohet të jenë autorët e vendosjes së tritolit ku u plagos Lulzim Kulla dhe 7 të tjerë. Gjithashtu, gjykata la në burg edhe shtetasin Serxho Teta, pasi akuzohet për moskallëzim krimi. Të pandehur mohuan akuzat gjatë seancës gjyqësore duke theksuar se nuk kanë asnjë lidhje me ngjarjen e ndodhur.

Pamje nga vendi ku ndodhi shpërthimi

SEANCA GJYQËSORE

Në sallën e gjyqit dy autorët dhe shtetasi Teta kanë mohuar se kanë lidhje me ngjarjen e ndodhur në 13 janar ku objektiv ishte biznesmeni Kulla për arsye që ende nuk janë të qarta. "Atë ditë kam qenë në Shkodër, por kam qenë për të blerë lëndë narkotike cannabis sativa. Nuk kam asnjë lidhje me ngjarjen për të cilën akuzohem. Nuk jam unë autori i vendosjes së tritolit", ka deklaruar Endri Çopja në sallën e gjyqit gjatë seancën për masën e sigurisë ndaj tij. Argel Lulaj edhe ai i akuzuar si autor i vendosjes së tritolit me 13 janar mohoi akuzat ndaj tij duke thënë se ka qenë thjeshtë si shoqërues i shokut të tij Endri. "Unë nuk kam lidhje me atentatin. Unë kam qenë në Shkodër me 13 janar vetëm për të shoqëruar shokun tim Endri. S'kam asnjë lidhje me ngjarjen dhe nuk jam unë autor siç akuzohem", tha Argel Lulaj në gjyq. Edhe Serxho Teta, i akuzuar për "moskallëzim krimi" ka mohuar akuzat ndaj tij duke thënë se ishte thjeshtë shoqërues. "Unë nuk kam informacion për atentatin dhe as autorët. Isha në Shkodër si shoqërues me shokët e mi dhe nuk di asgjë më shumë për çfarë akuzohem",-deklaroi shtetasi Teta. Nga ana tjetër, prokurori Albert Murçaj ka kërkuar "arrest me burg" për tre shtetasit e akuzuar pasi ka prova të mjaftueshme që mund të vërtetojnë se Endri Çopja dhe Argel Lulaj janë autorët e vendosjes së tritolit me 13 janar në Shkodër. Dy autorët e dyshuar Endri Çopja dhe Argel Lulaj sipas organit të akuzës janë identifikuar përmes pamjeve filmike ditën e ngjarjes nga kamerat e sigurisë e po ashtu janë vënë në përgjim pas 13 janarit kur ndodhi ngjarja. Këto janë provat që ka prokuroria deri tani ndërsa hetimet për ngjarjen vijojnë. Organi i akuzës pretendon se dyshimet e forta të dokumentuara përmes provave të deritanishme çojnë tek dy të akuzuarit. "Me 13 janar Endri Çopja dhe Argel Lulaj bashkë me shtetasin Serxho Teta kanë qenë në Shkodër, ditë kur ndodhi edhe shpërthimi me tritol në lagjen Rus duke lënë të plagosur shtetasin Lulzim Kulla që ishte objektivi dhe shtatë persona të tjerë. Tre shtetasit kanë ardhur me një makinë deri në Shkodër. Më pas kanë marrë motoçikletën në të cilën kanë vendosur sasinë e tritolit. Endri Çopja dhe Argel Lulaj kanë vendosur motoçikletën afër mjetit në pronësi të Lulzim Kullës dhe më pas kanë mundësuar shpërthimin e telekomanduar. Nga pamjet filmike nga kamerat e sigurisë këta dy shtetas janë parë afër vendit të ngjarjes, por edhe në një vend tjetër më larg. Pas ngjarjes dhe pamjeve filmike të sekuestruara dhe dyshimeve të para këta shtetas janë vënë në përgjim duke bërë që të kemi të tjera prova që mund të vërtetojnë se Endri Çopja dhe Argel Lulaj janë autorët e vendosjes së lëndës shpërthyese. Kërkojmë masën e sigurisë 'arrest me burg' duke u bazuar tek provat që kemi deri në këtë fazë të hetimit", tha prokurori Murçaj. Avokati mbrojtës Genci Gjokatuj kërkoi lehtësim të masës së sigurisë ndërsa pas seancës nuk pranoi që të komentojë për mediat. Në fund gjyqtari Hasan Selmi dha masën e sigurisë "arrest me burg" pa afat për Endri Çopja, Argel Lulaj dhe Serxho Teta.

NGJARJA

Me 13 janar shtetasi Lulzim Kulla mbeti i plagosur në një atentat ku u vendosën rreth 500 gram tritol e llojit C4 në lagjen Rus pranë makinës ku kishte parkuar biznesmeni. Bashkë me të u plagosën edhe 7 shtetas të tjerë. Pas hetimeve të deritanishme policia dhe prokuroria kanë arritur të arrestojnë tre shtetasit, dy prej të cilëve të dyshuar si autor të vendosjes së tritolit. Pas arrestimit të tre shtetasve të akuzuar në Elbasan, prokurori i Shkodrës Anton Martini dhe drejtori i policisë vendore Gjovalin Loka u shprehën në një deklaratë për mediat se nevojiten të tjera prova për të dokumentuar dhe zbardhur të plotë ngjarjen dhe se hetimet vazhdojnë përsëri. Seanca për masën e sigurisë në gjykatën e shkallës së parë në Shkodër u zhvillua nën masa të rrepta sigurie ndërsa gjyqi u zhvillua me dyer të mbyllura.

Policia

LËVIZJET

Drejtori i ri i Policisë, Ardi Veliu shkarkoi nga detyra e zv.drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, Rebani Jaupaj, dhe në vend të tij është emëruar Xhovalin Lokaj. Ndërsa Jaupaj është emëruar Drejtor i Analizës së Informacionit në Policinë e Shtetit, duke zëvendësuar në këtë detyrë Shaban Nexhin.

Abuzuan me pronat në Gjirin e Lalzit, arrest me burg për 2 ish-zyrtarët

Gjykata e Durrësit vendosi masën e sigurisë "arrest me burg" për 2 prej 4 ish-zyrtarëve që kryen abuzime me pronat në zonën e Gjirit të Lalzit. U la në burg ish-kreu i komunës Ishëm, Sulejman Ibrahimi, dhe ish-përgjegjësi i zyrës së Bujqësisë, Enver Shima. Ndërsa për sekretaren arkive Ornela Shëmlikaj dhe ish-punonjësen te Urbanistika, Shpresa Merdita, u dha masa e sigurisë "detyrim paraqitje". Katër ish-zyrtarët u ndaluan 3 ditë më parë pasi akuzohen për korrupsion dhe abuzim me pronat në bregdet. Më herët prokuroria bëri të ditur se ndalim i ish-zyrtarëve u bë pas një hetimi të kryer nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në bashkëpunim me Departamentin për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimit të Rënda në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, të filluar për shkak të abuzimit me ndarjen e tokave sipas ligjit për tokën, dhe të disa kontratave qiraje për dhënie të hapësirës publike plazheve.

Tentuan të kalojnë kufirin me 4 çanta me drogë, arrestohen 5 shqiptarë në Greqi

GREQI - Pesë shqiptarë kanë rënë në pranga, pas një operacioni të ndërmarrë nga policia greke në kufirin greko-shqiptar. Mësohet se shqiptarët iu janë sekuestruar 96 kg marijuanë. Droga u kap në Laka të Igumenicës. Mësohet se shqiptarët ishin duke kaluar kufirin në këmbë të ngarkuar me 4 çanta që përmbanin 55 pako me 96 kg 432 gram marijuanë. Ndonëse nuk dihen identiteti i tyre, thuhet se shqiptarët janë të moshave 26, 26, 31, 31 dhe 50-vjeç. Sakaq, atyre iu sekuestruan edhe 5 celularë.

Permbaruesi gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine :

"Toke Are truall nr pasurie 222/11, vol 4 , faqe 83 ne Zonen Kadastrale 3652 ndodhur ne fshatin Trush , Njesia Administrative Berdice , bashkia Shkoder
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e siperpershkruar , eshte në vleren 463,680 (katerqind e gjashtedhjete e tremije e gjashteqind e tetedhjete) leke

Shitja e pasurise do te behet (zhvillohet) me date **15.02.2018 ora 16.16** ne Zyren e permbaruesit gjyqesore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballe Gjykates se rrethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051, ose ne Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6

EPSA enforcement private service

SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"
SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:

1- Apartament nr.3 me sip. 90.5 m², ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri i Pasurisë: ND3/241+1-3, Vol.18, Fq.80, e ndodhur ne Rruga "N. Lena", Tirane. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te ABI BANK SHA dhe ISPA sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **79.640 Euro**.
2- Apartament nr.4 me sip. 103.4 m² , ZVRPP Tirane, ZK: 8250, Numri i Pasurisë: ND3/241+1-4, Vol.18, Fq.81, e ndodhur ne Rruga "N. Lena", Tirane. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te ABI BANK SHA dhe ISPA sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **90.992 Euro**.
3- Apartament nr.16 me sip. 189 m², ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri i Pasurisë: ND3/241+1-16, Vol.18, Fq.93, e ndodhur ne Rruga "N. Lena", Tirane. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te ABI BANK SHA dhe ISPA sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **166.320 Euro.**
4- Apartament nr.20 me sip. 103.5 m², ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri i Pasurisë: ND3/241+1-20, e ndodhur ne Rruga "N. Lena", Tirane. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te ABI BANK SHA dhe ISPA sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **91.080 Euro.**

Ankandi per te gjitha pasurite e sipërcituara zhvillohet ne date 22.02.2018, ora 16.00 ne zyren e shoqerise "EPSA" shpk te ndodhur ne Rr "Ismali Qemali", Pall Fratari, K.6, Tirane.

Per cdo informacion kontaktoni ne tel. **04 2262711 ose ne www.epsa.al**

Policia: Droga kishte destinacion Italinë

Ndalohet kamioni më 11 kg heroinë në portin e Durrësit, bie në pranga shoferi

DURRES- Policia Kufitare e Durrësit bllokoi ditën e djeshme një sasi rekord droge. Bëhet fjalë për rreth 11 kilogram lëndë narkotike e dyshuar heroinë, e cila kishte destinacion Italinë. Bëhet me dije se Heroina ishte fshehur në një kamion me targa 'AA 943 OO' që po transportonte qese plastmase. Uniformat blu arrestuan në flagrancë shtetasin Bujar Shazivari, 63 vjeç, i cili drejtonte kamionin. Uniformat blu deklaruan se sekuestrimi i drogës u bë falë kontrolleve intensive për parandalimin dhe goditjen e trafikut të lëndëve narkotike, bazuar në informacionet e marra në rrugë operative në bashkëpunim me agjencitë e tjera ligjzbatuese. Ndërkohë gjatë kontrollit të imtësishëm me qen antidrogë dhe fibroskop, rezultoi se në kabinën e kamionit MAN me targë AA 943 OO, nën krevatin e shoferit, në një vend të fshehtë u gjetën disa pako me lëndë të dyshuar heroinë. Mësohet se në vendngjarje mbërriti menjëherë grupi hetimor dhe specialistët e Sektorit të Hetimit të Narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës. Nga kontrolli u gjetën 10 pako të mëdha dhe një pako e vogël. Brenda tyre kishte lëndë narkotike të dyshuar heroinë dhe është sekuestruar në cilësinë e provës materiale. Do të kryhet dhe peshimi i saj. Kamioni ishte me ngarkesë me qese plastmase me destinacion Firenzze, Itali. Grupi hetimor po vijon punën për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarje, identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë të përfshirë në këtë trafik. Njëkohësisht është shkëmbyer informacion me homologet Italianë për të zhvilluar hetime të përbashkëta në lidhje me këtë rast.

Prokuroria rekurs në Gjykatën e Lartë: Tahirit t'i bllokohet pasaporta

Prokuroria e Krimeve të Rënda kërkon sërish që të vendosë sërish masën shtrënguese për bllokimin e pasaportës së ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri. Mësohet se prokuroria ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë vendimit të Apelit që i riktheu pasaportën Saimir Tahirit. Organi i akuzës e ka depozituar kërkesën për rekurs në datë 7 shkurt, ndërsa ende nuk është caktuar se kur do të zhvillohet seanca e parë. Më herët Apeli ia riktheu pasaportën ish-ministrit në datë 26 dhjetor të vitit të kaluar duke i hequr masën e ndalimit të lëvizjes jashtë vendit. Saimir Tahiri po hetohet nga Krimet e Rënda, pasi akuzohet se ka favorizuar anëtarët e dyshuar të grupit Habilaj në trafikun e kanabisit.

Shitën bizhuteritë, vlera e të cilave shkonte rreth 17 milionë lekë të vjetra

Grabitën argjendarinë në Shkodër, gjykata lë në burg dy autorët

Vukaj: Jam penduar, kisha një kredi për të paguar

Senad Nikshiqi

Gjykata e Shkallës së Parë në Shkodër la në burg shtetasit Françesko Vukaj dhe Iraldo Filipi pasi akuzohen për vjedhjen e argjendarisë "Dragusha" në zonën e quajtur tregu valutor në Shkodër. Kjo ngjarje ndodhi dy javë më parë në orët e para të mëngjesit. Në sallën e gjyqit Françesko Vukaj ka pranuar se është ai autori i vjedhjes së argjendarisë ndërsa shtetasi tjetër i akuzuar Iraldo Filipi deklaroi se ai nuk ka lidhje me vjedhjen dhe se ka qenë aty duke pritur shokun e tij, por se nuk ka pasur dijeni se çfarë do të bënte ai.

SEANCA GJYQËSORE

Gjatë seancën Françesko Vukaj shpjegoi edhe arsyet për vjedhjen e saj. "Unë e kam vjedhur argjendarinë Dragusha, sepse kisha një kredi për të paguar në një prej bankave të nivelit të dytë në Shkodër. Nuk kisha mundësi ekonomike dhe nuk po ia dilja për ta shlyer ndaj mendova që të bëj vjedhjen e argjendarisë për të shlyer kredinë. Jam penduar për çfarë kam bërë, por për momentin e pashë si zgjidhje për të dalë nga problemi ekonomik",-tha Françesko Vukaj. Në fakt, dëmi i bërë në argjendari Dragusha është rreth 17 milion lekë të vjetra teksa janë vjedhur një numër i konsiderueshëm bizhuterish. Pothuajse të gjitha këto bizhuteri janë shitur në pika të ndryshme dyqanesh në Shkodër, të cilat pranojnë të blejnë ar të përdorur. I akuzuari, i cili pranoi se është ai autori, ka treguar për policinë të gjitha pikat ku ka bërë shitjen e bizhuterive. "Unë pasi i kam vjedhur bizhuteritë i kam shitur në vende të ndryshme në Shkodër aty ka pranojnë të blejnë ar të përdorur. I kam shitur, sepse kisha nevojë për paratë për të shlyer kredinë. I kam thënë policisë dyqanet ku i kam dërguar. Nuk kisha çfarë të bëja tjetër ndaj i shita",-ka thënë Vukaj ndërsa ka shprehur pendesën e tij. Ndryshe nga Vukaj, shtetasi Iraldo Filipi ka mohuar se është bashkëpunëtor në vjedhjen e argjendarisë. I akuzuari ka thënë se thjeshtë ka shkuar për të pritur shokun e tij në afërsi të vendit të ngjarjes, sepse ia ka kërkuar, por pa pasur idenë se çfarë do të bënte Françesko Vukaj. "Unë kam qenë pak metra larg ku ka ndodhur vjedhja. Në fakt, nuk kam pasur asnjë ide se Françesko do të bënte atë vjedhje. Ne jemi shokë dhe më ka kërkuar që ta pres afër vendit ku ka ndodhur vjedhja. Unë e kam pritur, por se kisha idenë se çfarë kishte bërë",-tha shtetasi Iraldo Filipi. Pavarësisht këtij pretendimi prokuroria ka prova të mjaftueshme të siguruara që çojnë në dyshime të forta se Iraldo Filipi është bashkautor në vjedhje duke qenë se ka ndihmuar shokun e tij Françesko Vukaj. Forcat e policisë kanë shkuar në të gjitha dyqanet ku Françesko Vukaj ka shitur bizhuteritë që ka vjedhur dhe ka bërë të mundur sekuestrimin e tyre. Deri tani sipas burimeve janë gjetur pjesa më e madhe e tyre që kapin vlerën përafërsisht të 12 milion lekëve vjetër ndërsa po kërkohet edhe për pjesën tjetër që nuk janë gjendur ende. Bizhuteritë e sekuestruara pritet që me vendim gjykate t'i rikthehen argjendarisë "Dragusha", e cila u vjedh. Françesko Vukaj kreu vjedhjen me një makinë duke thyer qepenin e argjendarisë dhe duke u futur brenda për të marrë bizhuteritë. Mjeti me të cilin kreu vjedhjen rezulton i vjedhur dhe u braktis afër vendit të ngjarjes. Aty autorin e dyshuar e ka pritur Iraldo Filipi dhe së bashku janë larguar. Kamerat e sigurisë kanë identifikuar shtetasin Françesko Vukaj, i cili u arrestuar në periferi të Shkodrës 10 ditë pas vjedhjes së argjendarisë.

Argjendaria "Dragusha"

FRANÇESKO VUKAJ

"Unë e kam vjedhur argjendarinë Dragusha, sepse kisha një kredi për të paguar në një prej bankave të nivelit të dytë në Shkodër. Nuk kisha mundësi ekonomike dhe nuk po ia dilja për ta shlyer ndaj mendova që të bëj vjedhjen e argjendarisë për të shlyer kredinë. Jam penduar për çfarë kam bërë",-tha Françesko Vukaj.

NJOFTIM ANKANDI

Përmbarues gjyqësor privat Artan Sima, në datë 26/02/2018, ditën e Hënë, ora 16,00, përfundon ankandin e ri (të parë), për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Apartament" me sipërfaqe 34,8m2, e ndodhur në Bilisht, Bashkia Devoll në vlerën 1.840.000 lekë. Pasuria është lenë garanci nga debitorët z.Genci Sami Berberi banues në Bilisht, Bashkia Devoll, për detyrimin ndaj kreditorit Fatmir Ymer Kutrolli.

Ankandi zhvillohet pranë zyrës së përmbaruesit me seli lagjen nr.3, Rruga « Avni Rustemi », nr.31 .k,1. Korçë. Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com

Ekzekutimi i Kasmit, Efthimious: Policia shqiptare po më mban në burg pa pasur prova

I akuzuar për ekzekutimin e Dëfrim Kasmit në tiranë pasditen e 29 janarit, Efthimiou Efthimious, në një intervistë për mediat greke ka folur nga burgu i Bradasheshit, ku ndodhet aktualisht në paraburgim. Efthimious ka deklaruar se është i pafajshëm dhe se polica nuk ka prova ndaj tij. "Jam i pafajshëm. Është një gabim shumë i madh. Është tragjike kjo që po më ndodh. Sigurisht që nuk e kam bërë unë. Jam stërvitur në jetën time vetëm për të mbrojtur jetë dhe jo që të marr jetë. Policia donte që të gjente një viktimë që të lehtësonte veten nga çështja dhe gjeti dikë, pasi kishte siguruar disa të dhëna mbi gjatësinë dhe mjekrën e vrasësit, të dhëna që përputhen me mua. Është e mundur kjo? Pa asnjë fakt e provë, pa pistoletë, pa shenja gishtash, pa ADN",-është shprehur Efthimious për mediat greke. Gjykata e Krimeve të Rënda më herët ka dhënë masën e sigurisë "arrest me burg", për grekun dhe tre të arrestuarit e tjerë, si të dyshuar për vrasjen e Devi Kasmit në kryeqytet. Efthymiou Efthymious 41-vjeç, dyshohet të jetë ekzekutori i Kasmit; Elton Halipaj, mendohet të jetë personi, i cili siguroi mjetet për vrasjen; Malvin Dinellari mendohet se siguroi infrastrukturën dhe Elton Hoxhallari, i cili dyshohet të jetë bashkëpunëtor në vrasje. Ndërkohë vazhdon të jetë në kërkim Aurel Hoxhallari, i cili mendohet të jetë organizatori i krimit.

I arrestuari Efthimiou Efthimious

49 vjeçari nga Fieri: Nga pjatalarës, hapa restorantin tim në Calgary të Kanadasë

Hektori, vështirësitë e një jete në emigracion, nga Greqia në Kanada

"Të tre fëmijët e mi flasin shqip dhe jam krenar"

Voltiza Duro

Me ardhjen e demokracisë, mijëra shqiptarë filluan të largohen nga vendi duke marrë kështu rrugën e emigrimit drejt shteteve të ndryshme për një jetë më të mirë. Shumë prej tyre arritën të integrohen me kulturën e huaj, të krijojnë një bazë të fortë për të ardhmen, por pa harruar kurrë vendin e origjinës, Shqipërinë. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", Hektor Askushaj nga Fieri rrëfen të gjitha vështirësitë që ka kaluar në tokën e huaj, mallin për atdheun si dhe realizimin e ëndrrës së tij më të madhe. Tashmë, 49 vjeçari ka plot 15 vite që jeton në Calgary të Kanadasë së bashku me bashkëshorten e tre fëmijët e tij, të cilëve iu ka mësuar rrjedhshëm gjuhën shqipe. Aktualisht në këtë qytet të provincës së Albertës në Kanada jetojnë rreth 4 mijë shqiptarë që shpesh takohen me njëri-tjetrin në kuadër të organizimeve të shoqatës shqiptare-kanadeze në Calgary.

Para sa vitesh e morët vendimin për t'u larguar nga Shqipëria dhe cilat ishin arsyet që ju shtynë drejt emigrimit?

Vendosa të largohesha nga Shqipëria përfundimisht që prej muajit gusht të vitit 2003. Arsyeja kryesore që më shtyu të emigroja në një vend të huaj ishte dëshira për një jetesë më të mirë, diçka të cilën atdheu im nuk po ma ofronte.

Cilat janë disa nga shtetet ku keni jetuar e punuar si emigrant?

Menjëherë pas demokracisë në vitin 1991 provova të emigroja në shtetin fqinj, Greqi, por nuk kam pasur dokumente të rregullta e kështu që tentativat e mia nuk patën sukses. Këtë periudhë, për tre vite me radhë më është dashur të qëndroj e të punoj vetëm 4 apo 5 muaj në Greqi, por mungesa e një leje qëndrimi më detyronte që të kthehesha sërish në Shqipëri. Kështu që në 93' mora vendimin mos të shkoja më në Greqi pasi gjuhën nuk e dija, gjetja e një pune ishte e vështirë, çka më bënë që të kthehesha sërish në qytetin tim, Fier për 10 vite me radhë.

Në 2003 ju u larguat përfundimisht nga Shqipëria. Si e realizuat këtë?

Kisha rreth 8 muaj që kisha aplikuar për bashkim familjar në Kanada dhe përgjigjja që po prisja rezultoi pozitive. Tani po bëhen plot 15 vite që jetoj në qytetin Calgary, në Alberta të Kanadasë.

Hektor Askushaj me familjen

VESHTIRESITE

Menjëherë pas demokracisë në vitin 1991 provova të emigroja në shtetin fqinj, Greqi, por nuk kam pasur dokumente të rregullta e kështu që tentativat e mia nuk patën sukses.

EKSPERIENCA

Kur shkova në Kanada punoja si pjatalarës e më vonë si ndihmës kuzhinier në një restorant. Por ëndrra ime ishte që të hapja një restorant timin e dalëngadalë, falë punës së pareshtur arrita të bëhesha bashkëpronar në një restorant grek.

Cilat janë disa nga llojet e punëve që keni kryer në emigrim?

Fillimisht kur shkova në Kanada punoja si pjatalarës e më vonë si ndihmës kuzhinier në një restorant. Por ëndrra ime ishte që të hapja një restorant timin e dalëngadalë, falë punës së pareshtur arrita të bëhesha bashkëpronar në një restorant grek. Ndërsa në qershor të 2011 arrita të hapja restorantin tim të parë e në prill të 2016-ës hapa të dytin.

Sa keni arritur të integroheni me jetesën dhe kulturën kanadeze?

Mund të them që aktualisht ndihem shumë mirë, por në fillim ka qenë e vështirë të adaptohesha me kulturën dhe jetesën në Kanada. Tashmë që kam plot 15 vite këtu mund të them se jam integruar mjaftueshëm me jetesën, ashtu siç e kam dashur Apoloninë e Fierit dhe plazhin e Semanit, po ashtu e dua Hokin (Flames) dhe dëborën në Calgary. Por jetesa këtu është më e mirë, e nuk është e nevojshme të japësh para në spital për t'u kuruar, dhe fëmijët po arsimohen më së miri. Kështu që jam i kënaqur që po u siguroj fëmijëve të mi një të ardhme më të mirë.

Me kë jetoni dhe a ju mungojnë njerëzit e afërm?

Unë jetoj me bashkëshorten time Entela si dhe tre djemtë e mi; Fabio, Albi, dhe Elio. Jam i rrethuar nga shumë miq dhe shokë, por nuk mund të them se nuk më mungon familja ime e madhe që jeton në Shqipëri, me të cilët kontaktoj sa herë që më jepet mundësia. Pavarësisht angazhimeve që kam, mundohem që çdo vit të shkoj në Shqipëri, të takoj njerëzit e të nxjerr mallin.

A dinë fëmijët tuaj të flasin shqip?

Patjetër që po! Dhe dua të theksoj se jam shumë krenar që të tre fëmijët e mi flasin shqip. Edhe prindërit e tjerë shqiptarë që jetojnë në Calgary po tregojnë shumë interes që fëmijët e tyre të mësojnë gjuhën e origjinës, gjuhën shqipe. Madje në këtë qytet të Kanadasë ka një shkollë shqipe e numri i fëmijëve shqiptarë që shkojnë aty po rritet dita ditës.

Sipas informacioneve që ju keni, sa është numri i shqiptarëve që jetojnë në Calgary të Kanadasë dhe a mbani kontakte me njëri-tjetrin?

Në bazë të informacioneve që kam, në qytetin e Calgary-t jetojnë rreth 4 mijë shqiptarë. Normalisht që mbajmë kontakte e takohemi me njëri-tjetrin, kjo edhe falë faktit që restoranti im ka qenë dhe vazhdon të jetë vendi në të cilën shoqata Albanian-Canadian Assosiation of Calgary u formua dhe organizon ende mbledhjet me bashkatdhetarët shqiptarë. Ne shpesh bëjmë takime, flasim, diskutojmë e më besoni se nuk ka gjë më të bukur.

Cilat janë disa prej punëve që kryejnë shqiptarët që jetojnë në këtë qytet?

Shqiptarët që jetojnë në Calgary punojnë në fusha të ndryshme, duke nisur nga ndërtimi deri te inxhinieria apo dhe në industrinë e vajit e të naftës që është një nga industritë më të rëndësishme të provincës së Albertës.

Cili është mesazhi juaj për të gjithë emigrantët shqiptarë?

Mund të them se me shumë vullnet dhe punë mund të arrijnë që të gjitha dëshirat e ëndrrat të bëhen realitet. Kështu që mos u dorëzoni, por punoni fort e do të shikoni rezultate shumë shpejt, pa e harruar kurrë faktin që në venat tona rrjedh gjak shqiptar.

Reshjet dëmtojnë rëndë themelet mbështetëse

Moti i keq, rrezikohet ura 200 vjeçare e Kordhocës në Gjirokastër

Reshjet e dendura të shiut kanë shkaktuar dëmtime të shumta në Urën e Kordhocës në Gjirokastër. Ujërat e shumta të Drinos në sezonin e shirave dhe mungesa e vëmendjes në vite kanë dëmtuar themelet mbështetëse të këmbëve të saj. Gjendja e rënduar e urës evidentohet më së shumti pas tharjes së lumit. Drejtoria e monumenteve në Gjirokastër ka folur prej kohësh për një projekt restaurimi që pritet të zbatohet në muajt e verës pas shterimit të ujërave. Deri atëherë, shpresojmë që edhe kjo urë, e cilësuar si monument kulture, të mos ketë fatin e urës 200 vjeçare të Hoshtevës në Zagori të Gjirokastrës e cila u shemb përfundimisht si pasojë e motit të keq e vërshimit të ujërave vetëm një javë më parë, duke iu shtuar listës së pasurive të humbura monument kulture. Ura e Kordhocës, e ndërtuar rreth vitit 1820, në fillesat e saj lidhte tre qytete kryesore në Jug, Gjirokastër, Libohovë dhe Janinë. Ura me harqe është gjithashtu edhe një pikë lidhëse e hapësirës mes zonës së Lunxhërisë dhe Dropullit. E konsideruar si një ndër ndërtimet më të rëndësishme të periudhës otomane, ajo është e gjatë rreth 20 m dhe rreth 4 m e gjerë. Filma të tillë si "Ja vdekje, ja liri", "Dasma e Sakos" apo "Muri i gjallë" e kanë pasur këtë urë pjesë të skenave të tyre interpretuese.

Tabela/ Kategoritë që marrin strehim. Në 2017-ën, 1 mijë familje përfituese

Kreditë e buta, programi rihapet në fund të shkurtit

Veliaj: Çiftet e reja të ndjekin procedurat

Voltiza Duro

Kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj i ftuar si një ndër mysafirët e parë në shtëpinë e re të një çifti që përfituan nga programi

Çiftet e reja që ende nuk kanë një shtëpi, tashmë mund ta blejnë një të tillë nëpërmjet një kredie të butë. Kjo është bërë me dije nga kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj i cili theksoi se në fund të muajit shkurt do të rihapet programi i kredive të buta për të gjithë të interesuarit që nuk mundën të plotësonin dokumentacionin brenda afateve të thirrjes së parë. "Programi do të rifillojë në fund të shkurtit. Shpesh na është dashur të shpjegojmë se bashkia ka paketa të ndryshme, për kategori të ndryshme të shoqërisë. Që do të thotë, nëse je tërësisht në nevojë, kemi qendrat e emergjencës; nëse ke pak mundësi, kemi banesat sociale me qira minimale, 30 mijë lekë të vjetra; për dikë tjetër që thotë: 'Jo nuk dua të jem pronar i një shtëpie', kemi bonus qiraje. Por, kur vjen puna tek një kategori tjetër, pra për shtresën e çifteve të reja, që duan të krijojnë familjet e tyre në Tiranë, kredia e butë është një ofertë perfekte", u shpreh Veliaj. Ky i fundit shtoi se nëpërmjet këtij programi, Bashkia e Tiranës i erdhi në ndihmë plot 1 mijë familjeve të reja dhe në nevojë, që nuk kishin mundësi ekonomike për të përballuar interesat e tregut për të blerë shtëpinë e tyre. Kështu, çiftet e reja që dëshirojnë të blejnë një shtëpi brenda afatit të thirrjes së dytë, duhet të ndjekin të gjitha procedurat e nevojshme me bankën, në mënyrë që të shpallen fitues të kredisë së butë. Kryebashkiaku, ditën e djeshme ishte i ftuar si një ndër mysafirët e parë në shtëpinë e re të një çifti që përfituan nga ky program dhe në fjalën e tij theksoi se Albi dhe Adela (çifti i ri) e vlerësuan nismën e Bashkisë së Tiranës për t'iu gjendur pranë çifteve të reja, të cilët e kanë të vështirë të aplikojnë për ofertën e kredive hipotekore në treg.

KATEGORITË PËRFITUESE PËR STREHIM

- Familjet e reja
- Familje një prindërore me fëmijë në ngarkim;
- Familje me më shumë se tre fëmijë;
- Familje të shpronësuara;
- Familje të prekura nga investime publike;
- Familje emigrant i rikthyer;
- Rastet e dhunës në familje

KREDIA E BUTË

Projekti "Subvencionimi i interesave të kredisë", është një projekt i cili zbatohet për herë të parë nga Bashkia e Tiranës për ato familje apo çifte të reja, të cilat nuk kanë aftësi ekonomike të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekore në treg. Në vitin 2017-të, nga ky projekt u miratuan plot 1000 familje përfituese. Ndërkaq, kategoritë përfituese të programit për mbështetjen për strehim me synim përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve janë: familjet e reja; familje një prindërore me fëmijë në ngarkim; familje me më shumë se tre fëmijë; familje të shpronësuara; familje të prekura nga investime publike; familje emigrant i rikthyer, si dhe në rastet e dhunës në familje.

Ndërpritet energjia në disa zona

Reshjet e dëborës "pushtojnë" verilindjen, bllokohet Dibra

Pasditen e së djeshmes, reshjet e dendura të dëborës kanë "pushtuar" verilindjen e vendit, duke krijuar edhe vështirësi në disa zona. Kështu fshati Klenjë në Trebisht të Dibrës është bllokuar pasi trashësia e dëborës ka arritur në 55 cm. Rrugët nacionale janë të lira, por disa fshatra të thella janë izoluar e mjetet e kanë të vështirë qarkullimin. Ndërkaq edhe në Trebisht dhe Ostren të Bulqizës, trashësia e dëborës ka arritur në 25 cm, e disa fshatra janë bllokuar në njësinë administrative të Lurës, Kalanë e Dodës dhe në Selishtë në rrethin e Dibrës. Në disa fshatra në këtë zonë, trashësia e dëborës është 35 cm. Por probleme janë konstatuar edhe në Kukës, ku dëbora ka rënë me intensitet të lartë për disa orë paraditen e së dielës në lartësitë mbi 700 metra, trashësia e së cilës në aksin Fushë Dukagjin-Tuneli i Kalimashit arrin deri në 20 centimetër. Në këtë situatë, 5 borëpastruese të kompanisë mirëmbajtëse të Rrugës së Kombit kanë larguar borën nga rruga dhe kanë hedhur kripë. Moti i keq i shoqëruar me erëra të forta ka sjellë ndërprerjen e energjisë elektrike në disa njësi, si Grykë-Çajë, Gjolaj, Has, në disa fshatra të njësisë Bytyq. Ndërkaq, edhe në Qarkun e Korçës trashësia e dëborës ka arritur në disa zona në 40 cm, ndërsa rruga drejt fshatit turistik të Dardhës kalohet vetëm me zinxhirë.

Rektori i UT-së: Të jepen pagat për pedagogët

Pedagogët e Universitetit të Tiranës kanë bërë ankimim pasi nuk kanë marrë ende pagat. Në një deklaratë, Rektori i Universitetit të Tiranës Prof. Dr. Mynyr Koni është shprehur se mosdhënia e pagave është një veprim i paprecedentë nga autoritetet përgjegjëse të ngarkuara me ligj, Bordi i Administrimit dhe Administratori i Universitetit. "Jam shumë i shqetësuar në lidhje me mospagesën për punën tuaj të kryer për muajin janar 2018. Në këto kushte Bordi i Administrimit duhet të kishte çelur fondin për pagat nga të ardhurat e institucionit. Kështu që në Universitetin e Tiranës, të ardhurat e trashëguara nga viti 2017 janë të mjaftueshme për çeljen e fondeve të pagave për personelin e Universitetit të Tiranës",-është shprehur Koni.

Prof. Dr. Mynyr Koni

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve të Bankës se Shqipërisë, për një periudhë një vjecare"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 6,500,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve të Bankës se Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 07 Mars 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Suedi Sverige

INSTAT Republika e Shqipërisë Instituti i Statistikave

INSTITUTE OF STATISTICS OF ALBANIA
TENDER NOTIFICATION

Institute of Statistics of Albania intends to award a contract for "**Equipment for data center and network, and installation**", in Tirana, Albania, with financial assistance from Sweden, represented by the Swedish International Development Cooperation Agency (Sida) under the project: Direct funding for procurement of IT-equipment and establishing a training center, with Sida contribution nr: 55020289.

The tender dossier is available at www.instat.gov.al: from **January 22, 2018.**

The deadline for submission of tenders is **February 22, 2018,** time 11.00 AM, at Institute of Statistics of Albania, Blv. Zhan D'Ark, No. 3, Tirana, Albania.

Possible additional information or clarifications/questions shall be published on the www.instat.gov.al, https://www.kommersannons.se/ sida/.

Tenderers may request clarification on any of the documents of the Tender up to the date of submission of offers.

SHKRIMTARET NE DIKTATURE
DOKUMENTET

EKSKLUZIVE/ Zbulohet dokumenti i shkurtit të vitit 1973, me diskutimet e aktorëve të njohur: Pirro Mani, Naim Frashëri, Sulejman Pitarka, Luan Qerimi, Mimika Luca, etj.

Letra për Enverin: Ja çfarë diskutuan aktorët e Teatrit Popullor për ndikimet moderniste

Raporti i Pipi Mitrojorgjit: "Sulejman Pitarka, tha: "Në mënyrën e vënies në skenë ka shumë kopjime të huaja"

Dashnor Kaloçi

Ky dokument arkivor që po publikojmë në këtë kapitull të këtij libri i përket muajve janar-shkurt të vitit 1973 dhe bën fjalë mbi dy mbledhje të organizatës bazë të partisë të trupës së Teatri Popullor dhe, gjithashtu, kolektivit të saj, apo siç njihej ndryshe para viteve '90-të, si "organizata e Bashkimeve Profesionale". Këto dy mbledhje konçidojnë me përfundimin e Festivalit të 11 Kombëtar të Këngës në Radio Televizionin Shqiptar, (dhjetor 1972-janar 1973), i cili vetëm pas pak ditëve nga mbarimi i tij, do të bëhej "objekt goditje" nga vetë Enver Hoxha, në fjalën që ai mbajti fillimisht në aparatin e Komitetit Qendror të PPSH-së dhe më pas (15-16 Mars 1973), në mbledhjen me aparatin e Presidiumit të Kuvendit Popullor. Ashtu siç duket dhe nga dokumenti në fjalë, në këtë mbledhje të Teatrit Popullor, që asokohe, por dhe më vonë do të ishte një ndër institucionet qendrore kulturore dhe artistike më me peshë në të gjithë vendin, i deleguar ka qenë, Pipi Mitrojorgji, (asokohe instruktor për Artin e Kulturën në aparatin e Komitetit Qendror të PPSH-së), i cili ka përgatitur edhe raport-informacionin në fjalë, "duke nxjerrë në pah problemet" që kanë dalë nga diskutimet e aktorëve të Teatrit Popullor, emra shumë të njohur, mjeshtra të mëdhenj të skenës dhe ekranit, si në atë kohë dhe më pas, si; Pirro Mani, Naim Frashëri, Sulejman Pitarka, Luan Qerimi, Mimika Luca, etj. Dhe ashtu siç duket dhe nga faksimilja përkatëse, ky raport i instruktorit të Komitetit Qendror, Mitrojorgji, i është dërguar për t'u parë personalisht Enver Hoxhës, i cili ka vënë dhe firmën e tij mbi faqen e parë të dokumentit. Po kështu, duket se pas Enver Hoxhës, dokumenti në fjalë iu është dërguar për ta parë, edhe disa prej anëtarëve të tjerë të Byrosë Politike, si Hysni Kapos dhe Haki Toskës, të cilët kanë dhe firmat aty, apo dhe Petro Dodes, i cili në atë kohë mbulonte sektorin juridik në aparatin e Komitetit Qendror të PPSH-së. Ajo që

Enver Hoxha

vihet re në këtë raport-informacion, është se të gjithë personazhet që janë kritikuar aty, ndonëse dy të parët pa ju përmendur emrat, si p.sh. autori i dramës "Viti 1961", apo siç ka qenë titulli në variantin origjinal i saj. "Shtëpia nr. 1961, Shpëtim Gina, (asokohe vetëm 22 vjeçar), dhe skenografi i saj, Ali Oseku, pak kohë më vonë do të bëheshin objekt sulmesh e goditjesh edhe në raporte të tjera (do i shohim më pas në dokumentet e kapitujt e tjerë në vijim të këtij libri), dhe do të kishin një fat tragjik. Shpëtim Gina do të humbte jetën në rrethana misterioze vetëm shtatë muaj më vonë, duke "u mbytur" në dy pëllëmbë ujë, në një pellg të lumit Drojë, afër Mamurrasit ku e kishin dërguar për të kryer zborin ushtarak. Ndërsa Ali Oseku që akuzohej "për modernizëm" do të përfundonte në burgjet politike të regjimit komunist për disa vjet me radhë. Po kështu në burgejte regjimit komunist do të përfundonte dhe kritiku i artit dramatik, Miho Gjini. Një gjë tjetër që vihet re në këtë dokument, gjë të cilën do ta ndeshim edhe më pas në mjaft dokumente të tjera në faqet e këtij libri, është dhe shprehja e Fadil Paçramit për Teatrin Kombëtar. "....është bërë si Teatri Bogdani", gjë e cila do të ishte një nga akuzat që do i bëheshin atij herë pas here në mjaft mbledhje dhe raporte, deri sa u arrestua dhe u dënua me vite të gjata në burgjet politike të regjimit në fuqi. Ashtu siç do të shohim edhe në dokumente të tjera në kapitujt në vijim të këtij libri, këto mbledhje që filluan nga gjysma e dytë e janarit të vitit 1973, (menjëherë pas Festivalit të 11 të Këngës në Radio-Televizionin Shqiptar) shënuan dhe prologun furtunës së madhe që do të ngrinte Enver Hoxha dhe udhëheqja e lartë e PPSH-së ndaj shkrimtarëve dhe artistëve në të gjitha institucionet kulturore e artistike, si n ë Tiranë ashtu dhe në të gjithë vendin. Gjë e cila do të vazhdonte gjatë gjithë atij viti dhe më pas, duke "dhënë rezultatet" me dënimin e të ashtuquajturit "Grupi liberal në Art e Kulturë" me në krye Todi Lubonjën e Fadil Paçramin. Ashtu si pjesa më e madhe e dokumenteve të këtij libri, edhe ky publikohet i plotë dhe pa asnjë shkurtim.

RAPORT-INFORMACIONI I PIPI MITROJORGJIT PËR ENVER HOXHËN

NE TEATRIN POPULLOR

Nga mbledhja e organizatës bazë të partisë më 24.I.1973 dhe kolektivit më 24.II.1973 me rastin e punimit të fjalimeve të shokut Enver kundër ndikimeve të ideologjisë, kulturës, artit të huaj, dualën këto çështje:

Edhe këtu, megjithëse në një masë më të vogël se sa në muzikë e

> Së shpejti libri më i ri, "Shkrimtarët dhe artistët nën diktatin komunist…" i gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi

në ndonjë fushë tjetër, janë çfaqur ndikime të huaja moderniste. Edhe këtu ka ekzistuar mendimi se duhet futur "e reja", duhet "ecur me kohën". Ndikimet moderniste janë çfaqur në këto fusha:

1. Në mënyrën e interpretimit skenik në pjesët teatrale.

Në vënd të një interpretimi realist ku gërshetohen mendimet dhe ndjenjat, aktorëve iu kërkohet një interpertim racjonalist, pa ndjenjë dhe pa emocione, një lojë e ftohtë dhe racionale. Kjo kërkohet nën atë që të evidentohej mendimi, të luftohet sentimenatalizmi, deklamacjoni, teatralizmi etj. Por në të vërtetë aktorit i kërkohej që të zhvishej nga interpretimi ideoemocjonal i rolit të vet. Hyri kështu në disa pjesë teatrale një temperament i huaj, nordik, ➔

Pipi Mitrojorgji


Ali Oseku

Miho Gjini para burgimit

Aktorë të Teatrit Popullor në vitet '70

që nuk përputhej me temperamentin e popullit tonë dhe në traditën realiste në teatrin tonë. Naim Frashëri në diskutimin e tij tha: "Tek ne është kërkuar interpretimi i natyrshëm. Në parim, është një kërkesë e drejtë. Por në fakt aktorit i kërkohej që të frenonte emocjonet, ndjenjat. Kjo vinte në kundërshtim me karakterin e popullit tonë, me veçoritë kombëtare, mbi të cilat krijohet edhe fytyra e teatrit shqiptar. Edhe pjesët e huaja ne duhet që t'i trajtojmë në terrenin shqiptar, të dallohet vënia e jonë në skenë, nga ajo e vëndeve të tjera".

Një aktor tjetër, Luan Qerimi tha se: "Duke luftuar pompozitetin, deklamacionet etj, flasim ftohtë pa emocjone. S'kemi qenë vigjëlentë ndaj thjeshtëzimeve moderniste. Këto janë quajtur si hap përpatra". Sulejman Pitarka, tha: "Në mënyrën e vënies në skenë ka shumë kopjime të huaja. Të gjithë aktorët vihen në mënyrë të ngurtë në pyetje nga spektatori pa lëvizur fare duke recituar pjesën ose duke lëshuar batuta". Kjo tendencë racionaliste justifikohej edhe me teoritë e Brehtit, të cilat u kundërvihen teorive të Stanisllavskit. (Për të dy këta nuk ka ende analiza kritike mbi teoritë teatrale, mbi atë çka duhet pohuar e mohuar prej tyre. Pirro Mani ngriti në diskutimin e tij çështjen se "nuk duhet të jemi robër të kultit të Brehtit apo Stanisllavskit, por të marrim prej tyre atë që na shërben".

(Siç duket në Teatrin Popullor por edhe në Institutin e Arteve e në ndonjë teatër tjetër, ka partizanë të njërit apo tjetrit teorisjen ose ide konfuze e sempletiste për të dy që në praktikën krijuese regjizorjale e aktoreske krijojnë konflikte).

Nuk duhet përjashtura fakti që tendenca racjonaliste e interpretimit të të pjesëve është ushqyer edhe nga ato drama të huaja ose tonat që kanë pasur prirtje racjonaliste. Mund të ketë edhe burime të tjera siç mund të jetë "teoritë" moderniste mbi teatrin që lulëzojnë në perëndim. Sidoqoftë kjo është çështje që duhet parë më thellë.

2. Në skenografi, e cila kaloj në konvencionalizëm jashtë mase deri në absurditet. Shumë skena e dekore në vënd që të lehtësojnë, pengojnë lojën e aktorit, në vënd që të qartësojnë idenë e çfaqjes, e errësojnë atë. Podiume e shkallë pa kriter e pa funksjon janë përdorur në shumë pjesë aq sa u shëndrua në një mani regjisoriale. Si shëmbull më i freskët u soll skenografia e pjesës "Viti 1961", në të cilën as merret vesh as vëndi, as koha se ku e kur zhvillohen ngjarjet, kur zhvillohen ato në Shqipëri e kur në perëndim. Pirro Mani tha se mendonin se "skenografia s'ka nevojë të shprehë ambjentin, atë e krijon njeriu, prandaj ajo mund të ishte dosido". Mirpo ka një kufi edhe në konvencjonalizmëm e aq më tepër të jetë i huaj siç ka pas në vënd në disa çfaqje. Por kur janë kritikuar dekoret e kësaj natyre, janë mbrojtur duke duke i cilësuar si krijime "modern të talentuara" dhe kritikuesit si injorantë.

3. Ndikime të huaja janë manifestuar edhe në përdorimin e efketeve të të ndryshme skenike regjizorjale jashtë çdo uniteti me brendinë e pjesës, të cilat kanë çuar në errësimin e personazheve, të figurave artistike (drita pistoletash, errësime skenash), muzikë e tepruar e në disa raste muzikë konkrete, si një akt të pjesës, "Viti 1961"), etj. Të gjitha këto janë quajtur si gjëra të reja, moderniste.

Sulejman Pitarka tha se: "Ndaj këtyre çfaqjeve të huaja jemi stepur sepse kishim frikë mos na quanin të vjetëruar. Ndërsa Mimika Luca tha se ata që çfaqnin dyshime, quheshin "pa kulturë".

Veç këtyre u ngritën dhe këto problem të tjera:

1. Dramat historike e ato mbi luftën Nacional-Çlirimtare, praktikisht janë hequr nga repertori mbasi nuk çfaqen më duke u justifikuar me arsye të ndryshme.

2. Ndaj disa aktorëve të moshuar nuk ka respekt dhe quhen të skaduar. Naim Frashëri tha: "Për të denigruar një grup shokësh aktorë të vjetër, pa hapur mirë gojën u është vënë epiteti "Konservator". Pothuajse të gjithë aktorët e Teatrit Popullor që jepnin mësim në Institutin e Arteve, janë hequr për të mos "infektuar" studentët me dobësitë e tyre. Miho Gjini (inspektor teatri në Ministrinë e Arsim-Kulturës), i ka cilësuar disa aktorë të vjetër si "limona të shtrydhur që duhen hedhur në kosh". Shoku Fadil Paçrami e ka cilësuar në një diskutim të Teatrin Popullor si "Teatri Bogdani", për të treguar kështu, shkallën e prapambetjes së tij.

3. Pjesa e fundit, "Orfeu zbret në ferr", e një dramaturgu amerikan nuk është zgjedhur me kujdes dhe ka mendime pro e kundra çfaqjes së saj. Ajo është pezulluar nga Komiteti Partisë së rrethit. Por justifikimi që u dha nga shoku Fadil nuk u quajt i drejtë. Ai tha se: "nuk është opurtune të çfaqet tani". Me të drejtë u kërkua të organizohet një diskutim krijues në kolektiv dhe të vendoset në se ka apo s'ka dobësi ideologjike, vlen apo nuk vlen të çfaqet.

Disa nga shokët e aparatit tonë që e panë çfaqjen, janë të mëndimit se ajo nuk meriton të çfaqet në publik për idetë e saj filozofike të pa pranueshme.

Lidhur me pjesët e huaja në të gjithë aktorët ndihej shqetësimi se mos tani do të ndalohen vënia e tyre në skenë. Më 1968-ën, u hoqën me urdhër, me listë, pa diskutim e sqarim. S'kanë bindje. Edhe një herë u sqaruar se Partia ndryshon qëndrimin dhe orientimet që ka dhënë në këtë drejtim.

4. Kur flitet për sukseset e dramaturgjisë e të teatrit shpesh thuhet se vetëm pas viteve '60-të ka suksese të vërteta dhe errësohet puna e zhvilluar para 1960. Nuk shikohen vitet '60-të si një etapë e lartë e cila ka bazën e vet të kaluarën.

5. Marrëdhëniet e Teatrit Popullor me Ministrinë e Arsim-Kulturës nuk janë të mira. U ankuan me të madhe për mungesë ndihme e konsiderate. Thanë se nuk vinë as për të parë çfaqjet, pa le të zgjidhin problemet krijuese.



Shpëtim Gina, skenarist, dramaturg; libretist



NË TEATRIN POPULLOR

Nga mbledhja e organizatës bazë të partisë më 24.I.1973 dhe e kolektivit më 24.II.1973 me rastin e punimit të fjalimeve të shokut Enver kundër ndikimeve të ideologjisë, kulturës, artit të huaj, dualën këto çështje:

Edhe këtu, megjithëse në një masë më të vogël se sa në muzikë e në ndonjë fushë tjetër janë çfaqur ndikime të huaja moderniste. Edhe këtu ka ekzistuar mendimi se duhet të futet "e reja", duhet "ecur me kohën". Ndikimet moderniste janë çfaqur në këto fusha:

1.- Në mënyrën e interpretimit skenik të pjesëve teatrale. Në vend të një interpretimi realist ku gërshetohen mendimet dhe ndjenjat, aktorëve u kërkohej një interpretim racjonalist, pa ndjenja e pa emocione, një lojë e ftohtë [...]

2

pjesën ose duke lëshuar batuta". Kjo tendencë racionaliste justifikohej edhe me teoritë e Brehtit të cilat u kundërviheshin teorive të Stanisllavskit. (Për të dy këta nuk ka ende analiza kritike mbi teoritë e tyre teatrale, mbi atë çka duhet pohuar e mohuar prej tyre. Piro Mani ngriti në diskutimin e tij çështjen se "nuk duhet të jemi robër të kultit të Brehtit apo të Stanisllavskit por të marrim prej tyre atë që na shërben". Siç duket në teatrin popullor e ndoshta edhe në Institutin e arteve e ne ndonjë teatër tjetër, ka partizanë të njerit apo tjetrit teorisjen ose ide konfuze e sempliste për të dy që në praktikën krijuese regjizoriale e aktoreske krijojnë konflikte). Nuk duhet përjashtuar edhe fakti që tendenca racjonaliste e interpretimit të pjesëve është ushqyer edhe nga ato drama të huaja ose tonat që kanë pasë prirje racjonaliste. Mund të ketë edhe burime të tjera siç mund të jenë "teoritë" moderniste mbi teatrin që lulëzojnë në perëndim. Sidoqoftë kjo është një çështje që duhet parë më thellë.

2.- Në skenografi, e cila kaloj në një konvencionalizëm jashtë mase deri në absurditet. Shumë skena e dekore në vend që të lehtësojnë pengojnë lojën e aktorit, në vend që të qartësojnë idenë e çfaqjes e errësojnë atë. Podiume e shkallë pa kriter e pa funksjon janë përdorur në shumë pjesë aq sa u shndrua në një mani regjizoriale. Si shembull më i freskët u soll skenografia e pjesës "Viti 1961" në të cilën nuk merret vesh as vendi as koha se ku e kur zhvillohen ngjarjet, kur zhvillohen ato në Shqipëri e kur në perëndim. [...] tha se mendonin që "skenografi [...]

3

figurave artistike (drita pistoletash, errësime skenash, muzike e tepëruar e në disa raste muzikë konkrete, si një akt të pjesës "Viti 1961") etj. Të gjithë këto janë quajtur si gjëra të reja, moderne. Sulejman Pitarka tha se "Ndaj këtyre çfaqjeve të huaja jemi stepur sepse kishim frikë mos na quanin të vjetëruar. Ndërsa Mimika Luca tha se ata që çfaqnin dyshime quheshin "pa kulturë".

Veç këtyre u ngritën edhe këto probleme të tjera:

1) Dramat historike e ato mbi luftën N.Çl. praktikisht janë hequr nga repertori mbasi nuk çfaqen më duke u justifikuar me arësye të ndryshme.

2) Ndaj disa aktorëve të moshuar nuk ka respekt dhe quhen si të skaduar. Naim Frashëri tha: "Për të denigruar një grup shokësh aktorë të vjetër, pa hapur mirë gojën u është venë epiteti "Konservator". Po thuajse të gjithë aktorët e teatrit popullor që jepnin mësim në Institutin e arteve janë hequr për të mos "infektuar" studentët me dobësitë e tyre. Miho Gjini (inspektor teatri në Ministri[...] aktorë të vjetër si "limo[...]

4

që ka dhënë në këtë drejtim.

4) Kur flitet për sukseset e dramaturgjisë e të teatrit shpesh thuhet se vetëm pas viteve 60 ka suksese të vërteta dhe errësohet puna e zhvilluar para 1960. Nuk shikohen vitet 60 si një etapë e lartë e cila ka bazën e vet të kaluarën.

5) Marrëdhëniet e teatrit popullor me Ministrinë e Arësim Kulturës nuk janë të mira. U ankuan me të madhe për mungesë ndihme e konsiderate. Thanë se nuk vinë as për të parë çfaqjet pa le të zgjidhin problemet krijuese.

6) Puna politike dhe ideologjiko-estetike është jashtëzakonisht e dobët. Nuk bëhen në rregull as mbledhjet e formës së edukimit dhe as zhvillohen tema, biseda, debate e diskutime për çështje të ndryshme ideo-estetike. Në këtë kolektiv vazhdojnë thash e theme servilizmat, qendrimet oportuniste, indiferentizmi, simpathitë e antipathitë në formë grupesh, egoizmat etj.

Pipi Mitrojorgji

28.II.1973

6. Puna politike dhe ideologjike-estetike është jashtëzakonisht e dobët. Nuk bëhen në rregull as mbledhjet e formës së edukimit dhe as zhvillohen tema, biseda, debate e diskutime për çështje të ndryshme ideo-estetike. Në këtë kolektiv vazhdojnë thash e themet servilizmat, qëndrimet oportuniste, indifernetizmi, simpathitë, antipathitë në formë grupesh, egozimat etj.

Pipi Mitrojorgji
28.II.1973

Vrasja e politikanit serb, kreu i Kuvendit: Akt kriminal kundër stabilitetit të Kosovës

Veseli për mediat kroate: Serbia duhet ta njohë Kosovën

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, njëherësh kryetar i PDK-së, ka dhënë një intervistë për agjencinë kroate të lajmeve, HINA, gjatë vizitës zyrtare në Kroaci. Ai ka folur për dialogun me Serbinë, Gjykatën Speciale, Ushtrinë e vrasjen e Ivanoviçit. Gjatë kësaj interviste, i pari i Kuvendit, është pyetur nga gazetarët kroatë, për mundësinë që Specialja t'i akuzojë ish-komandantët e UÇK-së që tani janë liderët e Kosovës. "Ne e dimë se kush ishte agresori dhe kush viktima. Por Kosova do të përmbushë të gjitha detyrimet e saj ndërkombëtare",-ishte përgjigja diplomatike e Veselit. Ai tha se Kosova dhe Serbia duhet të nënshkruajnë një marrëveshje ligjërisht të detyrueshme, pasi është një kusht për integrimin evropian të dyja vendeve, që u përcaktua edhe nga Strategjia e Zgjerimit të BE-së. "Nuk është e arsyeshme që politikanët e moderuar në Serbi të mos jenë në gjendje ta njohin realitetin dhe pavarësinë e Kosovës. Por çfarë duhet të bëjmë, është që të lëvizim larg konflikteve me fqinjët",-ka deklaruar i pari i Kuvendit. Duke folur për dialogun në Bruksel, Veseli është zotuar edhe për formimin e bashkësisë së komunave me shumicë serbe. Kreu i Kuvendit në Kosovë foli edhe për ushtrinë. Sipas tij formimi i Ushtrisë për një shtet të pavarur është i pashmangshëm. Ai pohon se ushtria e Kosovës nuk do të jetë kërcënim për askënd, dhe do të kontribuojë në stabilitetin e gjithë Kosovës, transmeton lajmi.net. Veseli thekson se të gjitha veprimet do të merren në koordinim me mbështetjen e Amerikës dhe të NATO-s. Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli thotë që vrasja e politikanit serb, Oliver Ivanvoiq ishte "llogari e brendshme serbe". "Ky ishte një akt kriminal kundër stabilitetit të Kosovës, pavarësisht se kush e ka kryer. Kjo është hera e parë që situata shkakton terror psikologjik të serbëve. Unë nuk paragjykoj se kush është përgjegjës, por kjo nuk është në interes të shqiptarëve dhe serbëve",-shtoi kryetari i PDK-së. Veseli ka premtuar se Kosova do t'i sjellë para drejtësisë kryesit e kësaj vepre.

KADRI VESELI
"Nuk është e arsyeshme që politikanët e moderuar në Serbi të mos jenë në gjendje ta njohin realitetin dhe pavarësinë e Kosovës. Por çfarë duhet të bëjmë, është që të lëvizim larg konflikteve me fqinjët", ka thënë Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Veseli.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli

Hulumtimi i kamerave, kryeprokurori Syla: Morën një gëzhojë nga vendngjarja

Atentati në Mitrovicë, Prokuroria: 1 muaj paraburgim për të arrestuarit

Vrasja e Oliver Ivanoviç, policët kishin zhdukur provat

Prokuroria Themelore në Mitrovicë po kërkon një muaj paraburgim për dy policët e dyshuar për keqpërdorim të provave në rastin "Ivanoviç". Kërkesa për paraburgim pritet që dorëzohet sot në Gjykatën Themelore të Mitrovicës. Këtë e ka konfirmuar për Express, prokurori Njazi Rexha. Gjithashtu, thuhet se policët e arrestuar janë Dragisha Markoviq dhe Zharko Jovanoviq. Njëri nga këta dy policë, në ditën e vrasjes së Ivanoviçit, ka marrë një gëzhojë nga vendi i ngjarjes. Dragisha Markoviq i lindur më 1970 dhe Zharko Jovanoviq edhe ky i lindur në vitin 1970, janë dy pjesëtarët e policisë së Kosovës, të cilët gjatë ditës së djeshme u arrestuan nën dyshimin se nuk ishin kujdesur për ruajtjen e vendit të ngjarjes pak minuta pas vrasjes së Oliver Ivanoviçit. Për këtë punë, Prokuroria Themelore në Mitrovicë, sot, planifikon që ta dorëzojë në Gjykatën Themelore kërkesën për një muaj paraburgim për dy policët e dyshuar për keqpërdorim në rastin Ivanoviç. Kështu ka deklaruar për Express të dielën, prokurori i krimeve të rënda në Prokurorinë e Mitrovicës, Njazi Rexha. Ndonëse ai ka deklaruar se më nuk e ka këtë lëndë. Sipas tij, lënda tashmë ka kaluar në duart e prokurores serbe në Veri, Jelena Mirjanik. Rexha nuk ka dhënë detaje se përse lënda ka kaluar tek prokurorja, ani se ka qenë ai, i cili i ka nisur hetimet fillestare për këtë punë. "Sot gjatë ditës është planifikuar që të dorëzohet lënda për paraburgim. Ata kanë qenë në detyrë ta ruajnë vendin e ngjarjes dhe nuk e kanë kryer detyrën e tyre siç duhet",-ka thënë Rexha për Express. E ndërkohë edhe kryeprokurori i Mitrovicës, Shyqri Syla, ka thënë se dy policët e dyshuar në ditën e vrasjes së Oliver Ivanoviçit, nga vendi i ngjarjes e kishin marrë një gëzhojë. Thotë se janë bastisur shtëpitë e tyre dhe se tek njëri kanë gjetur edhe një armë pa leje. "Mund t'ju konfirmoj se dy pjesëtarë të policisë, janë të arrestuar nën dyshimin se kanë manipuluar me provat. Gjatë hulumtimit të kamerave është parë që ata kanë marrë një gëzhojë nga vendi i ngjarjes. Janë bastisur në shtëpitë e tyre. Tek njëri është gjetur edhe një armë pa leje. Besoj që sot prokurori i çështjes ka bërë kërkesën për paraburgim",-ka thënë Syla. Lajmin për arrestimet e dy zyrtarëve policorë të Stacionit në Mitrovicën Veriore e bëri të ditur inspektorati policor. Sipas komunikatës së Inspektoratit, këta zyrtarë u arrestuan nën dyshimin për manipulim me prova. Inspektorati njoftoi se përveç arrestimeve, ka bastisur dy lokacione në Mitrovicën Veriore me urdhër të prokurorit dhe gjykatës. "Në datë 10.02.2018, në orët e pasdites hetuesit e IPK-së dhe PK-së kanë zbatuar urdhëresën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë dhe janë bastisur dy lokacione në Mitrovicën e Veriut", thuhej në komunikatën e mbrëmshme. "Gjatë bastisjeve është konfiskuar një revole e llojit TT si dhe dy karikatorë me nga 9 fishekë të kalibrit 7.62 mm që do shërbejnë për procedurën penale të mëtutjeshme". Të arrestuarve u është caktuar ndalimi policor prej 48 orësh. Politikani i serbëve të Kosovës dhe kryetari i Nismës Qytetare "Liri, Demokraci, Drejtësi" Oliver Ivanoviç u vra në Mitrovicën Veriore më 16 janar. Ai u varros një ditë më pas në Beograd. Vrasja e tij është dënuar gjerësisht nga zyrtarët e BE-së, ata serbë dhe kosovarë. Ai shihej një politikan i moderuar në Kosovë që përkrahte bashkëjetesën midis pakicës serbe dhe shumicës shqiptare. Megjithatë, ai po rigjykohej për urdhërimin e vrasjes së shqiptarëve të Kosovës në vitin 1999, gjatë luftës së Kosovës për pavarësi. Ai e deklaroi veten të pafajshëm. Serbia ka kërkuar përfshirje në hetimin për vrasjen e Ivanoviçit, ndërsa dy shtetet në mënyrë të tërthortë janë duke shkëmbyer informata për këtë vrasje.

NGJARJA
Politikani i serbëve të Kosovës dhe kryetari i Nismës Qytetare "Liri, Demokraci, Drejtësi" Oliver Ivanoviç u vra në Mitrovicën Veriore më 16 janar. Ai u varros një ditë më pas në Beograd. Vrasja e tij është dënuar gjerësisht nga zyrtarët e BE-së, ata serbë dhe kosovarë.

PROKURORI
NJAZI REXHA
"Sot gjatë ditës është planifikuar që të dorëzohet lënda për paraburgim. Ata kanë qenë në detyrë ta ruajnë vendin e ngjarjes dhe nuk e kanë kryer detyrën e tyre siç duhet", ka thënë prokurori Njazi Rexha.

KRYEPROKURORI
SHYQRI SYLA
"Dy pjesëtarë të policisë, janë të arrestuar nën dyshimin se kanë manipuluar me provat. Gjatë hulumtimit të kamerave është parë që ata kanë marrë një gëzhojë nga vendi i ngjarjes. Janë bastisur në shtëpitë e tyre. Tek njëri është gjetur edhe një armë pa leje".

GAZETA SHQIPTARE
Life pages
Suplement
E hënë 12 Shkurt 2018 REDAKTOR: VOLTIZA DURO

SI TË MBROHENI NGA VIRUSI

Ylli Merja: Fruthi, si ta kurojmë me bimët medicinale

FUNKSIONI KRYESOR I TIROIDES

Simptomat, si të kuptoni që keni probleme me tiroiden

Vlera Lekaj:

- Mjekja patologe: Ja komplikacionet që mund të shkaktojnë virozat e stinës

Si të luftoni gripin dhe të ftohurën, masat parandaluese

"Kujdes me përdorimin e tepërt të antibiotikëve"

• Forconi imunitetin duke konsumuar frutën e qitros. Kanella, erëza që lufton diabetin dhe infeksionet

Mjekja patologe: Ja komplikacionet që mund të shkaktojnë virozat e stinës

Vlera Lekaj:

Si të luftoni gripin dhe të ftohurën, masat parandaluese

"Kujdes me përdorimin e tepërt të antibiotikëve"

Mjekja patologe Vlera Lekaj

Voltiza Duro

Numri i pacientëve të prekur nga gripi apo virozat, që drejtohen në qendrat shëndetësore, ka arritur në 23 mijë brenda një javë. Fluksi i lartë tregon që Shqipëria ndodhet në situatën e një epidemie gripale, që më së shumti po prek fëmijët e të moshuarit. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në Gazeta Shqiptare mjekja patologe, Vlera Lekaj tregon se me shfaqjen e simptomave, zgjidhja më e mirë është konsultimi me mjekun e mosmarrja e medikamenteve të gabuara që mund të shkaktojnë edhe dëme. Mjekja e familjes më tej liston të gjitha simptomat që bëjnë të mundur dallimin e gripit nga e ftohura.

Si paraqiten shifrat e pacientëve të prekur nga gripi?

Është sezoni i virozave dhe pacientë të shumtë në numër paraqiten pranë mjekut të familjes, për të realizuar vizita mjekësore, sepse përballen me shenjat e gripit. Faktikisht është një zgjedhje e duhur për këdo që përballet me probleme shëndetësore të saposhfaqura t'i drejtohet mjekut. E veçanërisht në sezonin e virozave, ku dhe shumë pacientë tentojnë të vetëmjekohen duke marrë shpesh herë dhe një mjekim të gabuar, i cili mund t'i dëmtojë.

Cilat janë kategoritë më të rriskuara?

Shenjat e gripit kanë një manifestim të ngjashëm tek të gjithë, por në varësi të moshës, mbivendosjes së sëmundjeve të tjera, imunitetit mund të shfaqen më të rënduara. Tek fëmijët dhe të moshuarit sigurisht që vëmendja është më e madhe sepse virozat tentojnë të jenë më agresive dhe shpesh here komplikohen me Bronkit akut apo Bronkopneumoni.

Si mund t'i njohim shenjat e gripit dhe të mos i ngatërrojmë ato me një ftohje apo me një gjendje tjetër shëndetësore?

Gripi përgjithësisht shfaqet me simptoma klasike, të cilat janë: dhimbje koke, dhimbje fyti, rrufë, temperaturë e lartë, ethe, dhimbje muskulare. Te e ftohura, mbizotërojnë më tepër shenjat e dhimbjes së fytit dhe teshtitjes së shpeshtë, hundëve të bllokuara, si dhe kolla me sputum (kollë me gëlbazë), e cila është më e zakonshme në të ftohurën sesa tek gripi, i cili karakterizohet nga një kollë më e thatë. Temperatura dhe ethet nuk janë të zakonshme me të ftohurën, ato shkojnë më tepër me gjendjen gripale.

Çfarë rekomandoni ju si mjekë në këto raste, a mund të bëhet trajtimi me antibiotikë?

Në të dyja këto rrethana, pra si të gjendjes gripale dhe të ftohurës nuk rekomandohet përdorimi i antibiotikëve. Antibiotikët luftojnë infeksione me karakter bakterial, dhe asnjë nga këto situata nuk kanë agjent bakterial, si shkakësi, por atë viral. Kështu që antibiotiku nuk do japë efekt, përkundrazi do të shkaktojë efekte anësore.

Efektet anësore më të dëmshme të antibiotikëve janë pikërisht çregullimi i florës së traktit tretës, duke dhënë shqetësime të shumta gastrointestinale dhe genitiale(sidomos tek femrat), të cilat zgjasin në kohë. Dëmtimi i mukozës së stomakut që vjen si pasojë e përdorimit pa kriter të antibiotikut, bëhet dhe shkak për sëmundje të mëvonshme të stomakut si Gastrit apo Ulçer.

Cilat janë kështillat tuaja për kurimin e gripit?

Konsumoni lëngje në formë çajrash bimorë, fruta, të cilat janë të pasura me vitaminë C siç është portokalli. Përdorni paracetamol për temperaturën si dhe shurup për kollën.

Çfarë komplikacionesh mund të shkaktojë gripi?

Disa nga komplikacionet më të shpeshta të gripit, siç u përmendën pak dhe më lart, të ndeshura në punën e përditshme të mjekut të familjes janë: Sinuzitet, Bronkitet acute e deri në Bronkopneumoni. Janë pikërisht këto raste të cilat kërkojnë më shumë vëmendje nga ana e mjekut, për t'u diagnostikuar saktë dhe për të ndërhyrë më terapinë e duhur medikamentoze. Sinuzitet karakterizohen nga dhimbja e kokës, e cila është më specifike tek pjesa e ballit, vetullat, kocka e mollëzave e deri tek ndjesia e dhimbjes së dhëmbëve.

Cilat janë simptomat e bronkopneumonisë?

Rastet me Bronkit apo Bronkopneumoni përveç vizitës tek mjeku i familjes rekomandohet dhe skopia e pulmoneve. Të sëmurët ankohen për kollë me sputum, i cili nuk përmirësohet mbas gripit, temperaturë të lartë(por jo në të gjitha rastet), djersitje të shtuar si dhe dobësi trupore, këputje, paaftësi për punë. Në të gjithë këto raste komplikacionesh janë pikërisht të sugjeruar për t'u përdorur antibiotikët, ku në varësi të rastit, përcaktohet dhe lloji i antibiotikut, shoqërimi me shurup për kollën, si dhe terapia me vitamina për forcimin e imunitetit.

Çfarë ushqimesh duhet të konsumojnë të sëmurët?

Sigurisht që dieta ushqimore ka rëndësinë e saj në përmirësimin e gjendjes shëndetësore, ku një regjim i pasur me zarzavate, lëng mishi, fruta, mjaltë, çajra ndihmojnë në përballimin e sëmundjes dhe në forcimin e imunitetit.

A kanë besim pacientët te mjeku I familjes, apo drejtohen në QSUT?

Gjatë muajit janar janë kryer pranë mjekut të familjes mbi 500 vizita, nga të cilat kanë rezultuar me virozë rreth tyre dhe komplikimet e saj rreth 1/4, ose konkretisht 100 raste të përmbledhura me virozën e stinës, sinuzite, bronkite e bronkopneumoni. U sugjerojmë të gjithë pacientëve të shkojnë të vizitohen pranë qendrave shëndetësore, të marrin kështillat dhe mjekimin e duhur në rast përballje me virozën e stinës apo komplikacionet e saj.

Mjeku popullor: Si të mbroheni nga virusi, masat parandaluese që duhet të merrni

YLLI MERJA: Fruthi, si ta kurojmë me bimët medicinale

"Konsumoni hudhër e trëndafil të egër"

Voltiza Duro

Fruthi është sëmundje virale akute e ky virus bën pjesë në gjininë morbilli në familjen paramyxoviridae. Përhapja e tij realizohet nëpërmjet piklave të vogla të pështymës, nëpërmjet rrugëve respiratore të cilat kalojnë nga një individ te tjetri. Kur virusi zhvillohet në zona të kufizuara, si në pak familje, kemi të bëjmë me raste endemike, ndërsa kur fillon të marrë përmasa të mëdha, kemi të bëjmë me epideminë e fruthit.

Moshat më të prekura

Virusi i fruthit prek fëmijët që pas moshës 15 muajshe e deri në moshat e rritura. Koha më e përshtatshme për zhvillimin e virusit të fruthit është në stinën e dimrit dhe ajo e pranverës, pra ai do temperatura të ulëta dhe lagështirë ajrore të lartë. Personat që preken nga virusi i fruthit, identifikohen shumë lehtë nëse kryejnë një analizë laboratorike IgM, specifikë e antitrupave të fruthit. Epidemitë e fruthit më të mëdha në vendin tonë janë ato të vitit 1956 ku kishte afërsisht 1% të vdekshmërisë të popullsisë, pra në çdo 100 veta kishte një të vdekur nga fruthi. Në epideminë e vitit 1970-1971, vdekshmëria ishte e papërfillshme, ndërsa në 89'-90' kishte afërsisht 170 mijë raste të prekur nga virusi i fruthit. Sot, personat më të predispozuar për t'u prekur nga virusi i fruthit, janë ata të pavaksinuarit ose të paprekur nga virusi i fruthit më parë.

Simptomat e fruthit

Kuadri klinik i virusit kalon në katër faza. Faza e parë e inkubacionit është kur grimcat e vogla të pështymës të një personi të prekur nga virusi hyjnë në rrugët e frymëmarrjes së një personi tjetër. Në këtë moment, virusi fillon të ngjitet në qelizat epiteliale të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes te njeriu i shëndoshë dhe fillon aty fazën e inkubacionit. Nga këto qeliza ai më vonë kalon në gjëndrat limfatike regjionale, e tashmë kjo "gjë e gjallë" në organizmin e njeriut, fillon të shumëzohet me shpejtësi dhe jep vireminë parësore duke u përhapur në të gjithë trupin, kryesisht në sistemin monocito-macrofagocitarë. Pasi shumëzohet përsëri jep vireminë dytësore, pra virusi plotëson fazën e parë të inkubacionit. Kjo zgjat 1-2 javë. Gjatë kësaj periudhe, personi i prekur ndjen një këputje trupore, një vështirësi në frymëmarrje dhe ndonjëherë edhe një kollë të thatë. Faza e dytë prodromale zgjat afërsisht 1 javë dhe pasi ka përfunduar fazën e inkubacionit, viruset dalin në gjak dhe synojnë të pushtojnë qelizat dhe trupi tashmë fillon të prodhojë antikorpuse specifike kundër fruthit që të ulë numrin e viruseve në qarkullimin e gjakut, pra organizmi bëhet si një "fushë beteje" midis viruseve dhe antikorpuseve që duan të vrasin dhe të ulin numrin e virusit të fruthit. Pas konfliktit virus-antikorpus shfaqen në lëkurë ekzantematat dhe në mukozat e brendshme enantematat si rezultat i një reaksioni të hipersensibilizimit të vonuar të trupit. Po e njëjta shkallë dëmtimi, shfaqet edhe në rrugët e brendshme të frymëmarrjes ku epiteli fillon të skuqet, të enjtet, të deskumohet dhe viruset e tjera si ato të gripit ose bakterie të ndryshme shkaktojnë edema në mushkëri ose demielinizimin e saj. Faza e dytë karakterizohet me ethe, rrufë, skuqje sysh, kollë e thatë, dhe shfaqen njollat e Koplikut. Këto të fundit shfaqen pranë mishit të dhëmbëve, pranë zonës bukale e kjo është faza kur virusi i fruthit ka filluar jo vetëm të përhapet në tërë organizmin, por edhe të japë dëmtime. Pas kësaj, vjen faza e tretë ekzantemike ku në trup fillojnë të shfaqen ekzantematat makulopapuloze (plagë mbi lëkurë në përmasa të mëdha) që zgjasin afërsisht një javë. Këto shenja shfaqen në fillim në fytyrë dhe pastaj gradualisht zbresin në trup poshtë. Sëmundja është më e lehtë te personat me rezistencë më të lartë dhe më e fortë te personat anemikë dhe që sëmuren shpesh. Mbas këtyre shenjave sipërfaqësore, ku kemi ekzantema jo vetëm në pjesën e jashtme, por edhe në buzë, në pjesën e dhëmbëve. Faza e virusit fillon të shkojë drejt fundit e cikli i tij biologjik po vjen drejt fundit dhe trupi hyn në fazën e fundit në atë të konvaleshencës, pra është faza kur antikorpuset fillojnë të asgjesojnë deri në fund virusin e fruthit. Ky i fundit mund të sjellë ndërlikime nëse personat me rezistencë të ulët, janë të prekur edhe nga virusi i gripit ose vuajnë nga infeksionet e shpeshta bakteriale, dhimbjet e kyçeve, dhimbjet e kokës etj. Komplikacionet më të zakonshme janë ato që prejkin laringun, trakenë dhe bronket ose mushkërinë dhe meningjitet aseptike, encefalitet, çrregullimet në tretje deri në diarre.

Mjeku popullor Ylli Merja

Masat parandaluese

Vaksina kundër fruthit është mjeti më i mirë për t'u mbrojtur nga virusi, e kjo e fundit mund të japë temperaturë për 1-2 ditë, e mund të përsëritet duke i dhënë rolin e një vaksine kujtesë. Të sëmurët me fruth duhet të qëndrojnë larg ambienteve publike, dhe t'u shërbehet në mënyrë të veçantë në shtëpi. Duke parë personat e prekur nga fruthi, vendin ku prek dhe dëmton virusi, iu rekomandojmë të kryeni disa veprime ose shërbime që konsistojnë në rritjen e rezistencës së organizmit duke përdorur bimët mjekësore, fruta, perime etj. Ky përdorim minimizon efektin e virusit të fruthit në organizëm duke zvogëluar njëkohësisht edhe kohëzgjatjen e të katër fazave të tij. Tashmë që virusi i fruthit po ndihet në Shqipëri, është mirë që personat të konsumojnë 2-3 thelpinj hudhër në ditë, qoftë të infektuar apo jo. Çaji me trëndafilin e egër (rosa canina) ku fëmijët mund të përdorin 1-2 gota çaj në ditë, ose 10-15 kokrra, kurse të rriturit 15-20 kokrra trëndafil të egër çdo ditë. Fëmijët mund të përdorin gjysmë luge kafe me rrënjën e thanëzës (Gentiana lutea) duke e përzier atë me pak kos, ndërsa të rriturit përdorin afërsisht një lugë kafe me këtë rrënjë të bimës. Që të tria këto produkte, bëjnë shumë luftarake leukocitet, pra e asgjësojnë virusin sapo hyn në laring. Për të qetësuar sistemin respirator, për të mbrojtur inflamacionin e mushkërive përdorim bimë mjekësore që përmbajnë tanine, mucilagje, dhe antioksidantë të fuqishëm si çaji me aguliçe, me gjethen ose lulen e mëllagës, lulet e shtogut, bëjnë që mushkëria të jetë e mbrojtur karshi sulmeve virusale.

Simptomat, si të kuptoni që keni probleme me tiroiden

Shumë njerëz kanë një sërë problemesh me tiroiden dhe e kanë të vështirë që ta mbajnë nën kontroll. Sipas studimeve dieta e shëndetshme, mënyra e jetesës e aktiviteti fizik janë një fillim I mirë, një mënyrë e natyrshme nëpërmjet së cilës mund të shikoni përmirësime. Funksioni kryesor i tiroides është prodhimi i hormoneve të saj. Prodhimi në fjalë, përgjegjësohet për sasinë e hormoneve të prodhuara që kontrollojnë metabolizmin e përgjithshëm të trupit, akoma dhe energjinë e nevojshme të tij. Mirëpo shpesh herë ndodh të kemi zmadhim të tiroideve. Shkak parësor për shfaqjen e gushës (siç quhet në gjuhën e popullit) është pamjaftueshmëria e jodit.

Jodi

Jodi është një mikroelement që e gjejmë në mjedis dhe është tepër i nevojshëm për organizmin tonë. Jodi është i pranishëm kryesisht tek hormonet e tiroides, siç e ripërmendëm, funksioni kryesor i jodit është i lidhur me aktivitetin e këtyre hormoneve që janë përgjegjëse për funksionet metabolike, ndër të cilat rritjen trupore. Jodin mund ta gjejmë në disa ushqime si, peshku, qumështi, por edhe tek vezët. Prania e tij tek frutat apo zarzavatet varet nga terreni i kultivimit. Doza ditore e këshilluar është rreth 0,15 mg për të dy gjinitë, ndërsa gjatë shtatzënisë apo dhënies së gjirit doza rritet. Mangësia e jodit mund te shkaktojë Strumën (gushën), ose ndryshe rritjen e gjëndrës se tiroides. Gjëndra tiroide rritet për të kompensuar mungesën e jodit dhe nga mungesa e këtij te fundit në tiroide formohen disa noduj, këtu vlen të theksojmë se janë të ndryshëm si nga madhësia dhe nga funksioni i tyre.

Simptomat

Problemet si: mbipesha, dobësia shpirtërore, konfuzioni i të menduarit dhe mjaft të tjera, të cilat prekin trurin, madje edhe sistemin nervor, mund të shmangen me ndihmën dhe përdorimin e lëndëve natyrale të cilat ushqejnë tiroiden me ato elemente që nevojitet për t'u rikthyer në formën dhe funksionin e mëparshëm.

Simptomat kryesore të nënprodhimit të hormoneve nga gjëndrat e tiroideve janë:

- Lodhja fizike
- Rritja në peshë
- Dhembjet muskulore
- Thonjtë e butë (thyerja e shpejtë e tyre)
- Konstipacioni
- Marrja mendsh
- Mosrezistenca në ftohtësi
- Rënia e flokëve
- Buhatja e fytyrës
- Buhatja e mukozave të laringjit

Periudha e dimrit është ndër më të vështirat për personat që vuajnë nga hipoteroza, vishen shumë trashë, flasin ngadalë, veprojnë si të plogësht, kanë lëkurë të ashpër, të thatë, nuk djersijnë dhe më të shumtën e kohës janë të mërzitur.

Kërkime të ndryshme kanë treguar se fëmijët që kanë gushë, shfaqin koeficient të ulët inteligjence dhe rezistencë të reduktuar në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre, domethënë treguesi i inteligjencës së tyre është 10 - 14 herë më i ulët nga ç'duhej të ishte në raste normale. Kurimi më i mirë i gushës është mbrojtja me jod nëpërmjet kripës së jonizuar, për shembull, për fëmijët mjekimet më të rekomanduara janë disa lloje tabletash si: Letrox, Euxhyrox, Jodox. Një tjetër lloj mjekimi është vaksinimi me vaj të jonizuar. Mosfunksionimi normal i gjëndrës drejton në mbiprodhim hormonesh.

Prodhimi i tepërt i hormonit të tiroides quhet hiperterozë dhe ka disa simptoma të caktuara:

- Rrahje te shpejta zemre akoma edhe kur ndodhen në gjendje të qetë
- Humbje peshe pavarësisht se ushqehen normalisht
- Këputje të theksuar fuqish
- Dobësi
- Mosrezistencë në temperatura të larta
- Pagjumësi
- Djersë të tepërta
- Zmadhim kokërdhokësh

Metodat që përdoren sot për trajtimin e pacientëve me hiperterozë janë barnat antitiroidë, jodi radioaktiv dhe ndërhyrja kirurgjikale. Është e rëndësishme të themi se çdo metodë ka avantazhet dhe disavantazhet e veta, prandaj dhe zgjedhja përfundimtare mbetet gjithmonë në dorën e pacientit.

Këshilla

Forconi imunitetin duke konsumuar frutën e qitros

Qitro, është një frutë që ng jason me portokallin, por ka një shije më të athët e është i njohur për vlerat e tij kuruese, veçanërisht në tretjen e ushqimit. Kjo frutë me origjinë greke është një burim i jashtëzakonshëm i vitaminës A dhe C madje përmban acid pantotenik, bakër, fibra, potas, biotinë dhe vitamin B1. Vitamina C që gjendet në nivele të larta tek qitroja ndihmon sistemin imunitar, si dhe lufton virozat dhe gripin. Gjithashtu, qitro pakëson rrjedhjen e gjakut nga mishi i dhëmbëve, si dhe shëron ftohjen dhe bën të mundur stabilizimin e kolesterolit. Kjo frutë rekomandohet të përdoret nga personat që kanë mangësi me sheqerin, pasi ndikon në rritjen e nivelit të tij në organizëm. Ngjyra rozë e ndezur ose e kuqe tek tuli i qitros vjen si pasojë e pigmentit likopen. Ky i fundit nuk gjendet tek qitroja me tul të bardhë. Pigmenti është i njohur për aftësitë anti-kancerogjene dhe ka kapacitetin më të lartë për të luftuar radikalet e lira që dëmtojnë qelizat në trup. Ndërkohë, ata që vuajnë nga gurët e veshkave nuk duhet ta ndajnë qitron nga ushqimi i tyre. Ndërsa për të gjithë personat të cilët kanë vështirësi në tretjen

e ushqimit, rekomandohet të merren 100 grame rrënje qitro e të zihen ne 500 ml ujë derisa të avullohet gjysma e tij. Lëngu i përfituar, pasi filtrohet, përzihet me një sasi të barabarte verë të kuqe të vjetër. Nga ky lëng këshillohet të merren një deri në dy gota në dite. Por konsumimi I qitros duhet shmangur nga personat që marrin edhe ilaçe pasi kjo frutë ndërpret procesin e shpërbërjes së shumë lloj ilaçeve, përfshi barnat për trajtimin e sëmundjeve të zemrës, alergjive dhe kolesterinës së lartë.

Kanella, erëza që lufton diabetin dhe infeksionet

Kanella është një nga erëzat e njohur jo vetëm për aromën e shijen e saj, por edhe për vlerat shëndetësore mbi organizmin e njeriut. Por shumica e njerëzve nuk janë në dijeni për ekzistencën e dy llojeve kryesore të kësaj erëze. Të dyja janë të shëndetshme, por njëra prej tyre përmban një toksinë që është shumë e dëmshme nëse konsumohet me tepricë. Kanella është një erëz që merret nga pjesa e brendshme e pemës Cinnamomum. Varieteti Kasia i kanellës vjen nga pema Cinnamomum cassia që ndryshe mban emrin "Cinnamomum aromaticum" ose Kanella Kineze. Kanella Kasia konsiderohet si një erëz me një cilësi të ulët. Ajo kushton pak dhe konsumohet në mbarë botën. Pothuajse e gjithë kanella që shitet në treg është e varietetit Kasia. Rreth 95% e vajit të erëzës është lloji cinnamaldehyde, që i jep kasias një aromë të fortë dhe pikante. Cejloni, ose "kanella e vërtetë," ka vendlindjen në Sri Lanka e në pjesët jugore të Indisë dhe ka një ngjyrë kafe të ndezur me shkopinj me shtresa të buta, dhe cilësi superiore. Kanella cejlon është më pak e zakontë dhe shpesh është përdorur si erëz gatimi, madje përshkruhet si një erëz me aromë të ëmbël delikate, e mrekullueshme për ëmbëlsira. Rreth 50-63% e vajit të saj esencial është e llojit cinnamaldehyde, një sasi shumë e ulët në krahasim me varietetin Kasia. Kanella Cejlon dhe ajo Kasia janë të dyja të mira për diabetikët. Në veçanti, kjo erëz është vlerësuar për aftësinë që ka në mbajtjen nën kontroll të sheqerit në gjak, që është shumë e rëndësishme për njerëzit që vuajnë nga diabeti. Studimet kanë treguar se kanella ul shpërthimet e sheqerit në gjak, rrit ndjeshmërinë ndaj insulinës dhe përmirëson aspektet e metabolizmit që kanë lidhje me rezistencën ndaj insulinës. Doza standarde e kanellës Kasia duhet të jetë nga 1 deri në 6 gramë në ditë. Nëse konsumohet në këto proporcione, atëherë nuk ka efekte anësore. Të dyja varietetet kanë ndikim në uljen e nivelit të sheqerit në gjak dhe kundër diabetit. Por varieti Cejlon ka shumë më pak mundësi të shkaktojë dëme edhe nëse konsumohet në sasi më të mëdha. Varieteti Kasia përmban shumë kumarinë, që është toksike nëse merret në sasi të mëdha. Gjithashtu, kanella përmban antioksidantë të fuqishëm siç është polifenoli e lufton inflamacionin, infeksionet si dhe ndihmon në riparimin e dëmeve në qeliza.

HISTORIA

ABSURDI MË 1982

Shqipëria i kërkon bashkisë së Parisit heqjen e portretit të Skënderbeut

Arsyeja: Ua kanë dhuruar antikomunistët, janë veçse tradhtarët e vendit tonë, shërbëtorët e mbretit Zog

Dalin radiogramet, "këshilltari tha se do të njoftonte Shirakun dhe përfundimin Ambasadës"

Në foto: **Sheshi "Skënderbej" në Paris"**

Në "Gazeta Shqiptare" e datës 5 shkurt 2018 pub likuam pjesën e parë të historisë së emërtimit të një sheshi në Paris me emrin e Skënderbeut dhe se si rreth kësaj ngjarjeje u vu re mospajtim i thellë mes qeverisë komuniste të Tiranës dhe diasporës anti dhe jokomuniste të emigruar jo vetëm në Francë, por edhe në mjaft vende të tjera të Perëndimit. Në një farë mënyre do të ndodhte njëra prej betejave patriotike dhe politike më të mëdha të historisë tonë të shekullit të shkuar.

Për ta plotësuar sadopak këtë tablo tepër të veçantë, në dinamikën e të cilës kulmimi i parë qe në 1978, moment kur në 10 korrik u dha nga Këshilli Bashkiak i Parisit leja për ta emërtuar këtë shesh me "Skënderbej" dhe se, nën trysninë shtetërore të ambasadës shqiptare, u pengua përurimi i tij në 28 nëntor të atij viti, po vijojmë pjesën e dytë.

Kjo ka hop motin 1982.

Patën rrjedhur katërmbëdhjetë vite të këtij ballafaqimi, i cili prej çastit të tanishëm, viteve dymijë, mund të konsiderohet një epope e vërtetë. E ka domosdoshmërisht këtë cilësi, sepse ishte një ngjarje e nisur në 1968, në 500-vjetorin e vdekjes së Gjergj Kastriotit dhe se, siç ndodh me vullkanet e fuqishme, ka lënë më pas, deri në ditët e sotme, llavë ende të paftohur mirë. *(fa.ni)*

Nga Ylli Polovina

PORTRETI I SKËNDERBEUT NË ZYRËN E NËNKRYETARIT TË BASHKISË SË PARISIT

Në 22 mars 1982 diplomati i lartë dhe mjaft i kualifikuar i ambasadës shqiptare në Paris, Th.H., i raportoi eprorëve në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë se kishte takuar në Bashkinë e kryeqytetit francez këshilltarin për problemet e kulturës, Patrik de Sajevski. Para pak kohësh ky pati qenë edhe nëndrejtor i Institutit të Lartë të Konstruksioneve Mekanike dhe të Materialeve. Ato çaste kur zhvilluan bisedën Patrik qe shkëputur prej kësaj detyre për ta pasur më të lehtë të zhvillonte veprimtari politike. Sipas diplomatit të rëndësishëm shqiptar në Paris, bashkëbiseduesi ishte golist, me pak fjalë bënte pjesë në partinë Bashkimi për Republikën, të cilës i takonte edhe Zhak Shiraku, kryebashkiaku ato çaste i kryeqytetit francez, i cili pati mundësuar realizimin e propozimit të mërgatës shqiptare antikomuniste për emërtimin e sheshit "Skënderbej".

Sipas raportimit të Th.H., "Mbasi tregoi gatishmërinë e tij në drejtim të mundësive të organizimit të aktiviteteve mbi vendin tonë nga ana e qytetit të Parisit si p.sh. një ekspozite të madhe mbi kulturën shqiptare në Petit Palais në vitin 1984 me rastin e 40-vjetorit të çlirimit të vendit tonë, të ekspozitave të ndryshme mbi artin dhe traditat e popullit tonë, mbi artin bashkëkohor (pikturë dhe skulpturë), ekspozita fotografike mbi qytetet e Beratit dhe të Gjirokastrës, ekspozita mbi etnografinë shqiptare, etj., më tha se në zyrën e Zv. Kryetarit të Bashkisë së Parisit, Pier Bas, ndodhet një pikturë e bukur e Skënderbeut".

Vijon raportimi: "Me insistimin tim u futëm dhe pamë këtë pikturë. Ishte e vitit 1979 dhe e punuar nga një shqiptar me emrin Shuttié. Në të shkruhej "Dhuratë nga komuniteti shqiptar i qytetit të Parisit".

Menjëherë më tej: "Sekretarja e Pier Bas na shpjegoi se këtë pikturë e kanë sjellë shqiptarët që banojnë në Paris, me rastin e inagurimit të sheshit Skënderbe. Së shpejti piktura do të vendoset në një nga muzetë e Parisit - tha ajo".

Ja edhe reagimi i diplomatit të lartë shqiptar, doemos në përputhje me direktivën që u pati dhënë me kohë Tirana: "Unë u thashë se nga sa kam dijeni ne nuk kemi qenë dakord që ju të pranoni propozimin e tyre për të emërtuar atë shesh me emrin e Skënderbeut, mbasi këtu në Francë ka një përfaqësi zyrtare që shpreh dëshirat dhe aspiratat e popullit shqiptar. Ata nuk janë veçse tradhtarët e vendit tonë, shërbëtorët e mbretit Zog, të cilët morën arratinë me çlirimin e Shqipërisë".

Në mbyllje të informacionit të tij Th.H. shkruan: "Sajevski më tha se janë bërë shumë debate në këshillin e Bashkisë përpara se të vendosej që t'i jepej emri Skënderbe këtij sheshi. Kjo zvarritje u bë për vite me radhë. Nuk është bërë asnjë ceremoni me rastin e emërtimit të këtij sheshi, tha ai.

Sidoqoftë - u thashë unë - ne jemi të pakënaqur nga veprimi juaj për këtë çështje".

RINDIZET ÇËSHTJA E NXEHTË E PËRURIMIT TË SHESHIT "SKËNDERBEJ", PENGUAR DERI ATO ÇASTE NGA TIRANA ZYRTARE

Kështu në pranverë 1982 u përflak çështja që u duk sadopak e fashitur katër vite më parë. Këtë herë qeveria e Tiranës ishte edhe më e zemëruar. Përveç se nuk donte të ekzistonte në Paris, Francë apo në tërë faqen e dheut me emrin e Skënderbeut, si të propozuar prej mospajtuesve të saj ideologjikë, të mos kishte asnjë shesh apo rrugë, duhej të censurohej edhe një portret i thjeshtë i dhuruar prej të mësipërmëve. Edhe pse e pati krijuar një franko-shqiptar.

Por periudha nga 28 nëntori 1978, kur ia dolën ta pengonin përurimin e sheshit, deri në fundmars 1982 mes Bashkisë së Parisit (dhe Ministrisë së Jashtme Franceze), ambasadës shqiptare (dhe qeverisë së Tiranës), nuk patën rrjedhur ujëra të qeta.

Kur kjo, e drejtë e miratuar që në 10 korrik, as pas mbi pesë muajsh nuk u realizua dot, në 22 dhjetor 1978 përjetoi një zhvillim tjetër. Këtë ditë prej Tiranës u nis një radiogram i shifruar. Njerëzit e tyre në Paris duhej të hidheshin në sulm. Kabllogrami e udhëzonte ambasadën që të merrnin kontakt me Bashkinë e Parisit dhe t'i propozonin emërtimin e një sheshi tjetër me emrin "Skënderbej". Ambasada e bëri këtë kërkesë menjëherë, veç Bashkia nuk dha asnjë përgjigje jo vetëm brenda dhjetorit 1978, por gjatë tërë vitit 1979.

Mbase ngjarjet nën këtë pezullim të gjatë, gjithsesi të tensionuar, do të vijonin edhe ca kohë kështu, kur papritur gjithçka u trazua edhe më shumë. Në 20 prill 1980 Ambasada Shqiptare me radiogramin e saj Nr. 1032 njoftoi Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë se "grupi i të arratisurve që kishte marrë nismën për t'i dhënë emrin një sheshi të Parisit "Skënderbeg" dhe se këtë gjë ata "e njoftonin me anë të një trakti". Po ashtu radiogrami bënte të ditur se "ceremonia e emërtimit të sheshit do të bëhej në 6 maj 1980, duke u zbuluar pllaka përkujtimore" dhe se "ceremonia do të drejtohej nga gjenerali francez në pension Robert Kasò si përfaqësues i Bashkisë së Parisit".

Dymbëdhjetë ditë më pas, në 2 maj 1980, nëpërmjet radiogramit Nr. 1534, MPJ e Shqipërisë i dha udhëzime Ambasadës në Paris që të merrte kontakt urgjent me MPJ e Francës dhe të ndërhynte për të realizuar së dyti anulimin e kësaj ceremonie.



Në foto: **Radiogramet**

Ambasada reagoi me një përgjigje tre ditë më vonë, në 5 maj. Radiogrami i saj me numër 1072 e njoftoi qendrën se kishin marrë takim me zv. drejtorin për Evropën në MPJ, Zhan Pjer Maset, të cilit ia patën shpjeguar edhe njëherë të gjithë historinë e kësaj çështjeje dhe i kërkuan që të ndërhynte tek eprorët e vet për anulimin e kësaj ceremonie. Sipas ambasadës, Zhan Pjer Maset kishte thënë se qe dakord me tezën shqiptare dhe pati pranuar se do të ndërhynte. Ndërkohë kishte nënvizuar se "nuk mund të thoshte asgjë përfundimtare, mbasi ishte Bashkia ajo që do të vendoste definitivisht".

Ndërkohë pas këtij takimi, brenda po asaj dite të 5 majit 1980, Bashkia e Parisit i dërgoi ambasadorit me korrier të shpejtë një fteso për të marrë pjesë në ceremoninë e emërtimit e sheshit me emrin "Skënderbeg", i cili do të përurohej të nesërmen.

Ambasada menjëherë mori në telefon Maset në MPJ, të cilin e njoftoi çfarë sapo i kishte ndodhur dhe i kërkoi të ndërhynte për anulimin e kësaj ceremonie. Maset mori përsipër të ndërhynte dhe më vonë njoftoi se përfaqësuesi i kryetarit të Bashkisë së Parisit Zhak Shirak qe ngarkuar prej tij për të marrë kontakt me ambasadën për ta biseduar këtë çështje. Të njëjtën gjë, brenda kësaj dite të nxehtë të 5 majit 1980, e njoftoi me telefon edhe shefi i shërbimit diplomatik të Bashkisë. Ky madje kërkoi edhe ndjesë pse për këtë çështje nuk ishte këshilluar më përpara me ambasadën shqiptare.

Në 6 maj u bë përurimi i sheshit me emrin e Skënderbeut. Sipas Konsullit të Përgjithshëm në këtë vend, Idajet Hoxha, ➔

atë ditë ai u nis për në vendngjarjen problematike. Duke qenë se ishte edhe zbulues dhe në rregullat e rrepta të punës në misione të tilla duhej të ishin dy vetë, i kërkoi ndihmë pranie një truproje të një anëtari të Byrosë Politike, i cili ato ditë kishte ardhur në Paris për një mjekim.

Që të dy e ndoqën përurimin e sheshit "Skënderbej" prej diasporës anti dhe jo komuniste prej një distance dyqindmetërshe. Ishin vendosur në katin e dytë të një kafeje dhe prej dritareve të xhamta të saj panë grumbullimin e njerëzve, fjalimet që u mbajtën dhe më pas shpërndarjen. Edhe gjatë një bisede të dytë me Idajet Hoxhën, bërë pak ditë më parë, ai ngul këmbë se çdo gjë u zhvillua qetësisht dhe se pjesëmarrësit ishin të paktë. Nuk e pranoi as shifrën dyqind. "Nga lart, siç i pamë ne, na tha ai, dalloheshin qartë hapësirat e mëdha bosh mes njerëzve".

SIPAS KRISTO ZHARKALLIT, NJË PJESËMARRËSI NË PËRURIMIN E "PLACE SKANDERBEG"

Abdurahim Ashiku në fund të janarit të këtij viti botoi kujtimin e një pjesëmarrësi në këtë ceremoni. Ai quhet Kristo Zharkalli, prej shumë dekadash shqiptar i mërguar në Greqi. Dëshmia e tij është një ndër më të plotat e të sinqertat, tërësisht pa ngarkesë politike. Kristo, siç pohon vetë, nuk kishte marrë pjesë fare as në fushatën dymbëdhjetëvjeçare për këtë shesh.

"Isha në dijeni nga revista "Koha Jonë" të dibranit Isa Ndreu, rrëfen ai, që më vinte me daljen në dritë të çdo numri, nga shkrime dhe letra të ndryshme se po bëheshin përpjekje të përurohej një shesh në Paris me emrin "Sheshi Skënderbeg" me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar..."

Pak më tej: "Merreni me mend habinë dhe gëzimin tim kur mora një ftesë për të marrë pjesë në përurimin solemn dhe festim të këtij sheshi. Veçse për mua ftesa të tilla merrja përditë nga të gjitha anët e botës, për mbledhje, kongrese, festa etj. Nuk kishte asnjë peshë, kurrë nuk munda të udhëtoj dhe kjo për arsye të thjeshtë ekonomike.

Duket se Isa Ndreu e kishte parasysh këtë "dobësi". Bashkë me ftesën më dërgonte një letër ku më thoshte: "Bashkangjitur ju dërgoj edhe një çek për shpenzimet tuaja të para, sidomos për biletat e aeroplanit e për do shpenzime të duhuna për udhëtimin në Francë. Atje do të kini të siguruara të gjitha shpenzimet prej meje dhe e quaj nder që të të kemi mes nesh. Miku yt, Isai".

Më thoshte, gjithashtu, se ceremonia solemne do të bëhej më 6 maj 1980 dhe se aty do të përfaqësohej i tërë emigracioni shqiptar në botë. Kishin ardhur përfaqësues të të gjitha partive, ngjyrave si dhe përfaqësues të klerit shqiptar.

Arbëreshët kishin ardhur me një përfaqësi shumë të madhe.

Unë isha i panjohuri nga të gjithë dhe në aeroport më priste Leci duke ditur orën që do të arrija në Orli. Besoj se për të parën herë në histori zbritën në atë aeroport kaq përfaqësi shqiptare. Atje dëgjoje emra bombastikë të së kaluarës që tashmë ishin shndërruar në skelete dhe pleq. Por shikoje edhe të rejat arbëreshe që përbënin korin kishtar dhe kombëtar, si dhe disa klerikë, si nga arbëreshët ashtu edhe nga mbeturinat e emigracionit. Më bëri përshtypje që shumica njiheshin ndërmjet tyre".

Kristo Zharkalliu vazhdon: "Fjalën solemne e mbajti inxhinieri Vasil Gërmenji duke pas pranë gjithnjë Isa Ndreun. Domosdo pranë tyre gjendej edhe Leci e shumë të tjerë, sidomos gjatë meshës në kishën madhështore Notre Dame. Vura re se shumica, sidomos të moshuarve të njohur mes tyre, përqafoheshin e putheshin duke u krenuar me të drejtë se po arrinin që në zemër të Kryeqytetit Francez një shesh do të mbante emrin e Heroit Kombëtar Shqiptar.

Në mes të atyre njerëzve dhe të asaj atmosfere festive, unë e ndjeja veten tepër të vetmuar dhe, pse jo, të trishtuar. Të gjithë e dinim se përfaqësonim një të kaluar të perënduar dhe atëherë shpresat tona ishin krejt të paqena se dikur do të mundeshim të ktheheshim në Atdhe. Nga ana tjetër, kushdo nga ne përfaqësonte një tragjedi, cilido prej nesh kishte lënë prapa njerëz të dashur dhe varre të hapura nga dora vëllavrasëse.

Ndërkohë nuk kisha mundur t'i afrohesha Isa Ndreut, i cili ishte gjithnjë i rrethuar nga "burra me rëndësi", (kur ka torba fiq), vetëm kisha mundur ta përshëndes duke i dhënë dorën ndërsa Leci i thoshte se kush isha. Ai kishte mundur të murmurisë "gëzohem shumë", sepse dikush tjetër, një burrë i moshuar e tërhiqte tutje që t'i tregonte diçka.

Ishte burrë i pashëm atëherë Isai dhe megjithëse ishte 61 vjeç, akoma nuk ishte thinjur.

Vetëm kur mbaroi ceremonia dhe njerëzit filluan të ndahen me përqafime e premtime, Leci mu afrua dhe më tha se më kërkonte Isai.

Ai më përqafoi me ngrohtësi duke thënë: "Kisha shumë kureshtje me të njoftë! Të lumtë që more mundimin me ardhë. E shikoni, këtu ishte i ftuar edhe ambasadori i Tiranës, por ai nuk e bani kabull me nderu Skënderbeun e me bisedu me emigrantët! Me thanë të vërtetën mirë bani se kishte rrezik me u kriju ndonjë gjendje e pakandëshme..."

E NJËJTA NGJARJE SIPAS QEVERISË SË TIRANËS

Me radiogramin 1087, datë 8 maj 1980, ambasada shqiptare njoftonte Tiranën se "në 6 maj qenë grumbulluar në sheshin që do të emërtohej me emrin "Skënderbeg" rreth 500 shqiptarë të ardhur nga Belgjika, SHBA, RFGJ, Italia, Anglia dhe Franca dhe pjesa më e madhe e tyre ishin të arratisur. Midis tyre kishte pasur edhe një grup arbëreshësh me në krye dy priftërinj. Të gjithë këta kishin shkuar në orën 9.00 në "Notra Dame", ku kishin bërë një ceremoni të shkurtër pa pjesëmarrjen e autoriteteve zyrtare franceze. Këtyre u kishte folur një anëtar i komisionit nismëtar, i cili i njoftoi se me vendim të organeve qeveritare franceze nuk do të bëhet ceremonia e parashikuar nga Bashkia e Parisit, sepse kjo është një çështje diplomatike që ka të bëjë me marrëdhëniet midis qeverisë së Tiranës dhe qeverisë franceze dhe në këto kushte, ka shtuar ai, ne jemi të detyruar të zbatojmë ligjet e vendit".

Brenda të njëjtës datë, 8 maj 1980, një radiogram i dytë i shifruar, i koduar me numrin 1095, e njoftoi MPJ në Tiranë se në ambasadë u kishte vajtur këshilltari diplomatik i Bashkisë së Parisit, i cili "pati shprehur në emër të Shirakut keqardhjen për ngjarjen e papëlqyer lidhur me emërtimin e sheshit me emrin "Skenderbeg". Ai kishte kërkuar që ambasadori të merrte pjesë në ceremoninë në fjalë dhe t'i përgjigjej fjalimit të gjeneralit në pension Kasò. Në radiogram thuhet se "Përgjigja e shokëve të Ambasadës për këtë çështje ishte e prerë, se ne jemi kundër kësaj dhe se jemi për emërtimin e një sheshi tjetër me emrin "Skënderbeg", shesh i cili të gjindet nga Bashkia. Këshilltari tha se për sa më sipër do të njoftonte Shirakun dhe përfundimin Ambasadës".

Pas kësaj ngjarjeje MPJ i dha udhëzime Ambasadës që "ambasadori të kërkonte takim me Shirakun". Kjo kërkesë u përsërit mbi 5-6 herë, shënohet në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, por takimi nuk u dha asnjëherë, duke u justifikuar se është tepër i zënë me punë, se është me pushime, e justifikime të këtij lloji".

Në një informacion për tërë këtë histori katërmbëdhjetë vjeçare që ministri i Jashtëm, Reiz Malile në 16 nëntor 1982 i dërgonte Sektorit të Jashtëm të Komitetit Qendror të PPSH-së, thuhet se "Në qershor të vitit 1981 ambasada konstatoi se ishte vënë pllakata me emrin e Skënderbeut në sheshin e caktuar që në fillim, por pa ceremoni zyrtare. Sheshi është një vend i humbur dhe fare i papërshtatshëm për emrin e heroit tonë kombëtar".

Në Tiranë filloi trysnia diplomatike ndaj ambasadorit francez për ta fajësuar vendin e tij për lejimin e njëanshëm të dhënies së një sheshi në Paris me emrin e Gjergj Kastriotit dhe se ambasadori Dhimitër Lamani dhe ndihmësi i tij i parë Kujtim Hyseni duhej të merrnin një takim në Bashkinë e Parisit dhe të takoheshin me zv. Kryetarin e saj. "Këtij t'i thuhej pikë për pikë: "Nuk na vjen hiç mirë që Bashkia mban lidhje me grupe të tilla elementësh, të cilët kanë tradhtuar popullin shqiptar dhe nuk kanë asgjë të përbashkët me të. Veç kësaj ekspozojmë edhe pseudopiktura të prodhuara prej tyre në sallat e saj kur dihet fare mirë se ata përfaqësojnë llumin dhe reaksionin më të zi shqiptar dhe përpiqen të dëmtojnë marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë midis Shqipërisë dhe Francës".

Po ashtu të deklaronin se "Në interes të zhvillimit dhe të thellimit të marrëdhënieve midis dy vendeve tona është e nevojshme që kjo pikturë të mos ketë vend në Bashkinë e Parisit, por në asnjë vend tjetër publik në Francë".

FITOI "SANREMO"-n, RRËFIMI I ERMAL METËS: SHQIPËRINË E KUJTOJ NGA SHENJAT NË TRUP

Kantautori shqiptar, Ermal Meta dhe Fabrizio Moro janë fitues it e çmimit të madh në 'Sanremo'. Pas peripecive që kaloi shqiptari, ku fillimisht u pezullua njëherë nga gara dhe më pas u rifut sërish në konkurrim, Ermal Meta dhe Moro ia dolën me interpretimin e tyre, duke bërë për vete publikun italian. Mediat italiane kanë shkruar se kjo ishte jo vetëm një fitore, por edhe hakmarrje për të gjithë padrejtësinë që iu bë në këtë garë. "Non mi avete fatto niente" u pezullua përkohësisht për dyshim të thyerjes së rregullores së Festivalit, por pas vlerësimeve, "Rai" doli në përfundimin që kënga të vazhdonte garën, nga e cila dy këngëtarët u larguan si triumfues. Kantautori shqiptar, Ermal Meta, pasi është shpallur fitues i këtij edicioni në Sanremo nuk i ka fshehur emocionet. "Është një emocion i papëshkrueshëm. Unë ia kushtoj këtë çmim shtëpisë sime diskografike, që ka besuar te unë atëherë kur askush tjetër nuk besonte". Ndërsa këngëtari tjetër, Farbizio Moro, ia kushtoi çmimin djalit që e ndiqte live nga salla.

RRËFIMI

Ai ka rrëfyer për median italiane edhe jetën e tij në Shqipëri dhe rrugën drejt Italisë. Ermal Meta, këngëtari shqiptar që fitoi Sanremo, bëri jehonë pas kënges shumë të vlerësuar të tij "Vietato morire. Në mars të vitit të kaluar ka dhënë një intervistë për median italiane "Sorrisi". Në artikullin, kushtuar atij, të titulluar "Ju tregoj të gjithë të vërtetën e jetës sime", Meta flet për fëmijërinë e tij.

> "Nuk erdha në Itali me gomone", kënga që djali fierak i kushtoi babait dhunues

Ermali tregon për origjinën e emrit të tij: "Ermal është një emër shumë i përhapur në Shqipëri, vendin tim të lindjes. Do të thotë 'i ardhur nga mali'. Kultura shqiptare ka shumë emra të bukur". "Shqipëria është një vend i jashtëzakonshëm, por erdha në Itali para 20 vitesh me një traget bashkë me vëllain, motrën dhe nënën. Gënjejnë ata që thonë se kam ardhur me gomone. Linda dhe u rrita në Fier. Në Shqipëri kam qenë 5 vite më parë dhe jam ende i dashuruar me të. Kur më pyesnin në intervista e kujtoj me mall fëmijërinë time atje nga shenjat që kam ende në trup. Kënga ime "Vietato morire", ka në brendësi të saj një histori personale, teksti tregon rebelimin e një djali të abuzuar nga babai"- tregon Ermali. Madje Ermali ka treguar edhe si kaloi jeta e tij nga studimi në shkollë në skenën e festivaleve të mëdha. "I vogël kam bërë gjithnjë detyrën time me një përkushtim të plotë për të studiuar. Kam pasur nota të shkëlqyera: për sa i përket kokëfortësisë dhe vendosmërisë, askush nuk më rrahu. Edhe sot unë jam pak si kjo. Unë kam jetuar të gjitha vitet e adoleshencës sime në Bari, ku kam mbaruar shkollën e mesme, shkollën e mesme shkencore dhe ku kam studiuar gjuhët në universitet, kam nevojë vetëm për një provim. Ndërkohë, urgjenca ime për të bërë muzikë është bërë një profesion me kohë të plotë, duke filluar me grupet lokale", - thotë ai.

Opinioni i Ditës

Ushqim apo lëmoshë…? Shteti përballë biznesit

Nga Dr. Sorina Koti *

(Vijon nga faqja e parë)

... diktatoriale, ku imponimi dhe sundimi janë kryefjala e qeverisjes.

Pas kaq shumë reformash të nisura, të konsultuara dhe pak nga ato të përfunduara, biznesi shqiptar nuk po gjen dot frymëmarrje për t'u rritur, për të investuar, për të punësuar më shumë njerëz, për t'i dhënë ekonomisë shqiptare një nxitje për të lëvizur pozitivisht.

A e kuptojnë qeveritarët shqiptarë se ç'do të thotë treg i lirë dhe frymëmarrje për biznesin? Do e dyshoja fort përgjigjen e tyre, kur në gjithë këto vite, sektori prodhues dhe furnizues i ekonomisë sa vjen e rrudhet. Çdo vit përballemi me krizën e të bërit biznes në Shqipëri, me pamundësinë për të paguar gjithë detyrimet fiskale, me pamundësinë për të punësuar njerëz të rinj, me pamundësinë për të rritur aktivitetin tonë, me pamundësinë për të parashikuar se çfarë do të ndodhë në të ardhmen. Gjithë ky ngërç, mungesë e stimujve fiskalë si dhe mungesë informacioni, po e çon ekonominë shqiptare drejt një izolimi të ri, ku me keqardhje do konstatoja se jemi drejt një kolapsi të vetëdijshëm.

Sikur të mos mjaftonte gjithë barra fiskale, që duhet të paguajë biznesi shqiptar (gjithmonë duke marrë parasysh uljen e kërkesës për mallra, rënien e prodhimit dhe konsumit, rënien e fitimit dhe zvogëlimi i numrit të punëtorëve), qeveria ka ndërmarrë një nismë ku do detyrojë bizneset të paguajnë një vakt ushqimor prej 350-500 lek/vakti si dhe vend-strehim për punonjësit, të cilët janë larg vendbanimit të tyre.

Kjo është një nismë dhe premtim jashtëzakonisht shumë populist, i cili është mirëpritur nga punonjësit e kompanive. Por, a është llogaritur kostoja, që i shtohet biznesit? A do të kompensohet nga shteti kjo kosto e re?

Shteti përsëri ka vendosur të rëndojë biznesin, për të shmangur detyrimet e veta. Kjo nismë mund të funksionojë në shumë vende të zhvilluara ekonomikisht, ku punëtorët kanë brenda orarit të punës edhe një vakt ushqimi nga kompania, por kurrsesi nuk mund të funksionojë në Shqipëri, ku shteti vetë nuk e ka pranuar nëse do bëhet edhe ai pjesë e kësaj skeme për punonjësit e administratës. Realiteti në Shqipëri është i hidhur, pasi shteti vetë abuzon me nëpunësit civilë, duke i kërkuar biznesit të mbajë gjithë kostot e dështimit të tij.

Realiteti na tregon se nëpunësit civilë nuk paguhen për gjithë shërbimin, që kryejnë ndaj shtetit (ka edhe raste abuzimi, ku nëpunësi paguhet edhe pa punuar asnjë ditë në shtet); nëpunësit nuk i paguhen dietat, nëse kanë shërbime jashtë prefekturës së tyre; nëpunësit nuk i paguhet vakti ushqimor nga shteti; nëpunësit nuk i paguhet vendstrehimi nëse punon larg banesës së tij; nëpunësit nuk i paguhet shtesa në pagë, nëse punon jashtë orarit të punës etj.

Shteti ka dështuar për të përballuar krizën e njerëzve në nevojë dhe ndihmën ekonomike të familjeve, duke paguar 5600 lek/muaj për familje (skema e re për vitin 2018). Mesatarisht, një familjeje me 4 persona, në skemën e ndihmës ekonomike, i takon 186 lek/ditë (47 lek/person në ditë). Është e tmerrshme ta mendosh jetesën në këto kushte pagese, ku shteti tregon paaftësinë e tij për të nxjerrë popullin nga varfëria dhe kërkon nga biznesi, që të paguajë 10-fish më shumë për një vakt të vetëm.

Nëse shteti do kërkojë zbatim të kësaj nisme nga biznesi, atëherë ta fillojë nga vetja në fillim. Kur administrata shtetërore dhe familjet në nevojë të marrin mbështetjen e duhur dhe të trajtohen me respekt e dinjitet, atëherë t'i imponohet biznesit, i cili supozohet se funksionon në një treg të lirë e të pavarur…

** Drejtore Ekzekutive, Economic Intelligence Center*

HOROSKOPI

DASHI

Nëse në punë doni të jeni i qetë, përmbajuni në mënyrë të përpiktë rregullave dhe shmangni kundërshtimin e vazhdueshëm të veprimeve të eprorëve. Jeni të papërmbajtshëm, edhe për gjërat me të vogla. Organizohuni mirë, pushoni më shumë, zbavituni me miqtë.

DEMI

Me Hënën armiqësore mund të keni mosmarrëveshje me një familjar që ndërhyn në punët tuaja. Nuk keni fare dëshirë t'i thoni sesi doni të silleni. Do të keni pika të përbashkëta me dikë që ka ditur t'ju tërheqë vëmendjen, por nuk do të jetë e lehtë të pajtoheni.

BINJAKET

Keni dëshirë të vendosni një mirëkuptim edhe më të thellë me personin e zemrës, që do t'ju kuptojë menjëherë dhe do t'ju dëgjojë. Keni përkrah një partner vërtet të veçantë! Do të zmadhoni rrethin e të njohurve dhe do të krijoni kontakte të shumta me njerëz të ditur.

GAFORJA

Pozicioni i Hënës do të bëjë që situata të acarohet. Luftojini mendimet e këqija me një shëtitje në park apo duke dëgjuar muzikën tuaj të preferuar. Mund të bëni njohje të reja të këndshme. Do të përjetoni emocione të bukura.

LUANI

Në ambientin që frekuentoni, ka persona me të cilët keni të përbashkëta, por duke qenë se jeni i zënë me çështje të përditshmërisë, nuk e kuptoni. Mos ëndërroni udhëtime dhe ndryshime në vende utopike: nuk është koha të merrni nisma të reja.

VIRGJERESHA

Me mbështetjen e Hënës që ju favorizon do ta peshoni mirë një zgjedhje që do të bëni dhe do t'ia nisni punës. Do t'i tejkaloni situatat e zënkave dhe do të jeni bujarë. E keni kuptuar se për të zgjidhur disa çështje nuk duhet thjesht të mendoni, por edhe duhet të veproni.

PESHORJA

Shqetësimi nuk do të jetë i lehtë për t'u mbajtur nën kontroll. Do të bëjë që marrëdhëniet me të tjerët t'i keni sipas kapriçove të humorit. Qetësohuni! Nuk do të pranoni propozimin e një të njohurit, sepse më vonë do t'i ndiheni në borxh.

AKREPI

Me Saturnin dhe Uranin bashkëpunëtorë, mund të angazhoheni për të mbushur disa mungesa njohurish dhe të arrini të përgatitur për një sfidë shumë të pritur profesionale. Me Venusin mike, është e mundur që një krizë në çift të zgjidhet.

SHIGJETARI

Hëna në qiellin tuaj ju provon me emocione të ndryshme: nga një anë ju do ëndërrimtar dhe të shkëputur, nga ana tjetër pasionant dhe të angazhuar. Me partnerin mund të keni vështirësi të mirëkuptoheni rreth çështjeve që kanë ngelur në vend.

BRICJAPI

Me Jupiterin që i bashkohet shenjës suaj, padituria për t'i vënë fre sjelljes në disa raste mund të shkaktojë ndërlikime. Prandaj, veproni me mend. Jupiteri mund të bëjë që të keni disa vonesa administrative të bezdishshme. Kini durim dhe mos u dorëzoni!

UJORI

Me ndikimin Hënës që bashkëvepron me Venusin, pritet të kaloni një ndjenjë vështirësie që nuk mund ta shpërfillni lehtë. Bëni kujdes se çfarë thoni dhe sjelljes së papërshtatshme që mund të keni, sepse mund t'ju shkaktojë probleme.

PESHQIT

Nga bashkëveprimi i Neptunit në shenjën tuaj, priten gjëra të mira në fushën e dashurisë. Përgatituni të përfitoni. Do të keni në maksimum aftësinë tuaj tërheqëse dhe aftësinë për të joshur. Jeni duke shkuar drejt një të ardhme të shndritshme në dashuri.

Katovica

Kushti "kroato-slloven" i BE për Ballkanin Perëndimor

(Vijon nga faqja e parë)

Nga SHABAN MURATI

... të anëtarësohen në BE. Ky kusht nuk figuron në strategjinë e Komisionit Europian "Një perspektivë e besueshme e zgjerimit për angazhimin e BE me Ballkanin Perëndimor", që u publikua në datën 6 shkurt, dhe as në dokumentet e tjera zyrtare të BE, që kanë të bëjnë me kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojnë shtetet aspirante. Duke qenë se kushti i ri po paraqitet nga presidenti i Komisionit Europian, do të thotë se kushti jo vetëm ekziston, por edhe duhet konsideruar me seriozitet të madh nga vendet e Ballkanit Perëndimor për domethënien dhe implikimet, që mund të ketë.

Në datën 6 shkurt 2018, në fjalën e mbajtur në parlamentin europian përkrah kryeministrit të Kroacisë, presidenti i Komisionit Europian, Juncker, deklaroi se nuk do të ketë zgjerim të Bashkimit Europian me shtete nga Ballkani Perëndimor, derisa të zgjidhet konflikti midis Kroacisë dhe Sllovenisë për kufirin. Në datën 9 janar 2018 para takimit me kryeministrin e Sllovenisë, presidenti i Komisionit Europian, Juncker, deklaroi se konflikti slloveno-kroat për kufirin midis tyre rrezikon zgjerimin e BE nga Ballkani Perëndimor. Juncker deklaroi se zgjerimi i ardhshëm i BE me vendet e Ballkanit Perëndimor është në duart e Sllovenisë dhe të Kroacisë.

E thënë shkurt, presidenti i Komisionit Europian parashtron një kusht të ri, që e lidh pranimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor me zgjidhjen e konfliktit kufitar midis dy vendeve anëtare të BE, Kroacisë dhe Sllovenisë. Duke qenë se kushti i ri vjen nga nivelet më të larta të ekzekutivit të BE, kjo do të thotë që qeveritë dhe diplomacitë e vendeve ballkaniko-perëndimore duhet ta konsiderojnë të tillë.

Natyrshëm pyetja e parë, që lind në këtë rast, është se çfarë lidhje ka dhe përse duhet kushtëzuar pranimi në BE i shteteve të Ballkanit Perëndimor me konfliktin për kufirin midis dy shteteve anëtare të BE. As Sllovenia dhe as Kroacia nuk janë shtete të atij grupimi mekanik, të cilit i është vënë emri "Ballkan Perëndimor". Sllovenia, e cila u pranua në BE në vitin 2004, nuk ka qenë kurrë as formalisht me grupimin "Ballkan Perëndimor", kurse Kroacia, të cilën e futën forcërisht në këtë grup, që përfshinte vendet e procesit të Stabilizim-Asocimit me BE, u shkëput në vitin 2013, kur u bë anëtare e BE. Dy shtetet, qysh kur kanë shpallur pavarësinë e tyre në vitin 1991 kanë një konflikt të vjetër kufitar lidhur me një korridor detar prej 12 kilometra katrore dhe me koregjimin e kufirit tokësor. Bashkimi Europian mori përsipër ndërmjetësimin e këtij konflikti duke ngritur një gjykatë arbitrazhi, e cila dha vendimin e saj në dhjetor të vitit të kaluar. Por Kroacia ishte tërhequr nga procesi i arbitrazhit për shkak të dyshimeve për neutralitetin e trupit gjykues dhe ajo nuk e njeh vendimin e Gjykatës se Arbitrazhit. Realiteti i konfliktit kufitar midis dy vendeve të BE vazhdon.

Është e natyrshme që Brukseli t'i kushtojë vëmendje çështjes së grindjeve kufitare, që mund të kenë midis tyre shtetet e reja, që do të pranohen në BE, dhe që duhet të kenë zgjidhur mosmarrëveshjet kufitare midis tyre përpara anëtarësimit, me qëllim që BE të mos importojë edhe grindjet kufitare midis anëtarëve të rij. Me të drejtë këtë kërkesë e shpreh edhe strategjia e Komisionit Europian për Ballkanin Perëndimor e datës 6 shkurt 2018.

Nuk e gjen dot ndonjë logjikë diplomatike dhe politike që ta lidhë grindjen kufitare kroato-sllovene me pranimin në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Por përse zgjidhja e konfliktit kufitar midis dy shteteve anëtare duhet bërë kusht për pranimin e anëtarëve të rij të BE nga Ballkani Perëndimor? Nuk kuptohet dhe nuk shpjegohet se çfarë lidhje kanë mosmarrëveshjet kufitare midis anëtarëve të BE me pranimin e shteteve nga Ballkani Perëndimor. Nuk rezulton dhe nuk konstatohet as një lidhje direkte dhe as një lidhje indirekte midis dy çështjeve.

Bisedimet për çështjet kufitare janë çështje serioze shtetërore e kombëtare, që zgjasin me vite e me dekada, dhe nuk janë bisedime, që zgjidhen me dy raunde ahengjesh ballkaniko-perëndimore.

Sensibiliteti i Komisionit Europian duket se rrjedh nga përvoja e hidhur, që ai ka me shtetet anëtare, kur pranoi në vitin 2004 Sllovenинë, duke e ditur grindjen kufitare të saj me Kroacinë. E po atij viti është përvoja negative me Qipron, ku për arsye të paqarta pranoi anëtar një shtet, i cili ishte gjysmë shteti, sepse gjysma e territorit dhe e popullsisë ishte e ndarë që në vitin 1974. Askush nuk e ka shpjeguar përse BE e ndërmori këtë pranim ekstrapengues duke anëtarësuar vetëm Qipron greke. Edhe argumenti, që ka qarkulluar në qarqet diplomatike se kjo u bë për të ngritur një barrikadë të re kundër pranimit të Turqisë në BE, nuk duket bindës, sepse me këtë anëtarësim BE më shumë pengoi veten e vet se sa Turqinë. Për të mos thënë faktin e hidhur që Qiproja greke nxitoi të rreshtohej në krahun e Rusisë, të cilës i ka ofruar jo vetëm lehtësira ushtarake në territorin e saj, por edhe i ka shprehur gatishmërinë për të lejuar një bazë ushtarake ruse. Pranimi i një gjysmë shteti si Qipro është njësoj sikur në BE të pranohej Spanja pa Katalonjën, Britania e Madhe pa Skocinë apo Belgjika pa rajonin flamand.

Por BE ka ecur në një rrugë jo shumë të arsyeshme edhe në Ballkanin Perëndimor, ku i ka dhënë statusin e shtetit kandidat, ka filluar bisedimet e pranimit dhe madje në 6 shkurt i përcaktoi edhe datën e pranimit në vitin 2025 një shteti si Serbia, që ka gjithë ato probleme me shtetet kufitare. Vështirë të kuptohet avancimi i shpejtuar i Serbisë drejt anëtarësimit në BE, kur ajo nuk njeh një shtet fqinj të saj si Kosova dhe madje kërkon që të rikthejë statusin kolonial, megjithëse e ka të qartë se një ambicie e tillë serbe do të thotë luftë në Ballkan. BE është ndërmjetësuese e bisedimeve midis Serbisë dhe Kosovës dhe në 19 prill 2013 arriti që dy vendet të nënshkruajnë marrëveshjen e normalizimit të marrëdhënieve midis tyre, marrëveshje të cilën Serbia e ka shkelur me të dy këmbët dhe vazhdon të njëjtën politikë agresive të mosnjohjes së Kosovës.

Duke iu rikthyer kushtit të ri, që paraqiti presidenti i Komisionit Europian, Juncker, nuk mund të mos arrish në përfundimin se jo vetëm nuk ka një lidhje, por mund të thuash se ai kusht nuk u përket shteteve të Ballkanit Perëndimor, që aspirojnë të anëtarësohen në BE. Shtetet e Ballkanit Perëndimor as veç e veç dhe as si grup nuk janë në gjendje të ndikojnë apo të ndihmojnë në mosmarrëveshjen kufitare midis Kroacisë dhe Sllovenisë, ku dhe vetë BE po shfaqet e pafuqishme. Nuk mund të ketë lidhje anëtarësimi i Shqipërisë, i Kosovës, i Maqedonisë, i Serbisë, i Malit të Zi dhe i Bosnjë-Hercegovinës me kalendarin e zgjidhjes së grindjeve kufitare midis Kroacisë dhe Sllovenisë.

Konflikti kufitar midis Kroacisë dhe Sllovenisë është i vjetër 27 vjeçar, dhe nuk është zgjidhur dot as me bisedimet e stërgjatura dypalëshe midis tyre dhe as me ndërmjetësimin e BE. 27 vjet kanë bisedimet dypalëshe midis dy vendeve anëtare të BE, Bullgarisë dhe Rumanisë, për grindjen kufitare detare prej 17 kilometra katrore në detin e Zi dhe ende nuk janë zgjidhur. Bisedimet për çështjet kufitare janë çështje serioze shtetërore e kombëtare, që zgjasin me vite e me dekada, dhe nuk janë bisedime, që zgjidhen me dy raunde ahengjesh ballkaniko-perëndimore.

Mund të kërkosh sa të duash, por nuk e gjen dot ndonjë logjikë diplomatike dhe politike që ta lidhë grindjen kufitare kroato- sllovene me pranimin në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Duket si një artificë për t'i bërë vendet e Ballkanit Perëndimor që të presin aq gjatë në dyert e BE, sa do të kërkojë kohë zgjidhja e konfliktit kroato-slloven. Por nuk ka siguri që edhe pas zgjidhjes së konfliktit kufitar midis Kroacisë dhe Sllovenisë, Komisioni Europian të nxjerrë kushtin që të pritet derisa dy shtetet e tjera anëtare të BE, Bullgaria dhe Rumania të zgjidhin edhe ata grindjen e tyre kufitare.

Kushti i ri "kroato-slloven" i BE do të thotë që, edhe nëse plotësojnë të gjitha kriteret dhe kushtet e strategjisë së re të Komisionit Europian, vendet e Ballkanit Perëndimor nuk do të jenë në gjendje të anëtarësohen pa u zgjidhur grindjet kufitare midis shteteve anëtare të BE. Ndaj duket sikur ky kusht, në vend që të nxisë vendet e Ballkanit Perëndimor, ka më shumë efektin që të vonojë procesin e anëtarësimit të tyre në BE. Nëse dy shtete anëtare të BE kanë grindje kufitare midis tyre, ky është problem i vërtetë i tyre në planin dypalësh dhe është gjithashtu problem edhe i BE. Por ai nuk është kurrsesi problem i vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe aq më pak duhet të jetë kusht i anëtarësimit të tyre në BE.

Ndaj kushti i ri "kroato-slloven" i BE, paraqitur nga presidenti i Komisionit Europian, duket tejet i vështirë për t'u kuptuar dhe pranuar nga opinioni publik i vendeve të Ballkanit Perëndimor.

MBROJTËSI KUQEZI

Mavraj nuk mban më mbas humbjes: Po tregoj të njëjtën histori

Mërgim Mavraj duket za konisht një tip i qetë, por edhe mbrojtësin e përfaqësueses shqiptare duket se po e lëshojnë pak nga pak nervat pas paraqitjeve të fundit të Hamburgut, i cili është në zonën e ftohtë të renditjes dhe rrezikon seriozisht rënien në Bundesligën 2. "Sigurisht që kjo është një histori m... që po e tregoj çdo javë pas ndeshjeve, por ne nuk do të dorëzohemi dhe do të vazhdojmë të luftojmë. Nuk është një frazë e gatshme, por një besim që kemi si skuadër", tha futbollisti shqiptar për mediat gjermane. "Është e vërtetë që në luftën për mbijetesë na duhen pikë. Por tani na mbetet vetëm të marrim gjërat pozitive nga ndeshjet. Me paraqitjen tonë sot duhet të jemi të kënaqur", tha ai pas disfatës 2-0 të skuadrës së tij.

Legjionarët shqiptarë kalojnë një fundjavë pozitive. Nuk mungojnë fjalët e mira për ta

Një 19-vjeçar rikthen Interin tek fitorja

Karamoh vulosi suksesin e vështirë ndaj Bolonjës

Pas dy muajsh mung esë, Interi ka rigjetur fitoren pasi ka mundur në shtëpi Bolonjan me rezultatin 2-1. Një ndeshje, e cila i kishte të gjitha brenda, gafa mbrojtësash, supergol, kartona të kuq e gola. Të parët në avantazh kaluan zikaltërit, që në minutën e 2-të, falë një goli të Eder. Në minutën e 25, ishlojtari i Interit, Rodrgio Palasio ka përfituar nga një gabim në mbrojtje nga Miranda, duke barazuar rezultatin në 1-1. Në pjesën e dytë, Interi e ka kërkuar më shumë golin, dhe mundi është shpërblyer vetëm në minutën e 63, kur i riu 19-vjeçar, Karamoh shënoi një supergol. Në minutën e 68, Mbaje është ndëshkuar me karton të kuq. Vetëm pak minuta para fundit, edhe Masina ka marrë karton të kuq. Takimi është mbyllur në minutën e 100 për shkak të ndalesave të shumta gjatë lojës, teksa Palacio ka qenë shumë afër barazimit të lojës në minutën e 87. Me këtë fitore, Interi është ngjitur në vendin e tretë, me 2 pikë më shumë se Lacio. Në ndeshjet e tjera, Torino ka mundur 2-0 Udinezen. Me po të njëjtin rezultat, ka fituar edhe ekipi i Sampdorias përballë Veronës. Një fitore të vështirë ka arritur edhe Xhenoa në fushën e Kievos.

SERIE A

TË PREMTEN	
Fiorentina - Juventus	0-2
TË SHTUNËN	
SPAL - Milan	0-4
Krotone - Atalanta	1-1
Napoli - Lacio	4-1
TË DIELËN	
Sasuolo - Kajliari	0-0
Kievo - Xhenoa	0-1
Inter - Bolonja	2-1
Sampdoria - Verona	2-0
Torino - Udineze	2-0

LEGJIONARËT

Arlin Ajeti ishte protagonist ditën e djeshme me skuadrën e Krotones, teksa mori një pikë përballë Atalantës së Berishës, gjithashtu edhe duke asistuar tek goli. Përveç asistit, ra në sy edhe pozicionimi para linjës së mbrojtjes. Trajneri Zenga e aktivizoi si mesfushor me tipare mbrojtëse, por edhe për të ndihmuar në krijimin e aksioneve të reja. E, duke parë performancën e mirë të shqiptarit, nuk munguan as lavdërimet pas ndeshjes. "Gjatë javës ne kërkojmë zgjidhje alternative dhe pozicioni i Ajetit ishte ndër gjërat që kemi provuar. Ai u tregua i gatshëm për të luajtur, për të provuar gjëra të reja dhe gjithashtu asistoi në gol" - deklaroi Zenga. Këtë intervistë, e ka publikuar edhe vetë Ajeti në faqen e tij në Facebook, duke u ndjerë kështu krenar për fjalët e trajnerit të tij. Në fitoren 4-1 ndaj Lacios, dy mbrojtësit e krahut të Napolit, Hysaj dhe Mario Rui, kanë bërë një paraqitje të shkëlqyer dhe kanë marrë komplimente të pafundme, si dhe vlerësim maksimal nga shtypi sportiv. Mbrojtësi shkodran veçanërisht duket se ka bërë ndeshjen më të mirë të sezonit. "Il Mattino" shkruan për të: "Hysaj është për notën 8. Nuk ndalet gjatë gjithë kohës dhe lëviz shumë shpejt e me ide impresionuse. Milinkoviç-Saviç e mban të karikuar në pjesën e parë, por më pas nuk e kupton ku është lojtari i Lacios". "Corriere Dello Sport" e vlerëson me notën 6.5 dhe shkruan: "Napoli e bën lojën nga krahu i tij dhe Hysaj nuk ndalet kurrë". Po ashtu, edhe "Gazeetta Dello Sport" ka një vlerësim të mirë për mbrojtësin shkodran, ashtu si dhe për mbrojtësin e krahut të majtë, Mario Rui.

AKUZA

Januzaj: Van Gal më vrau karrierën!

Ish-lojtari i Mançester Junajtid, Adnan Januzaj, në një intervistë për britaniken "The Mirror", është rikthyer pas në kohë, duke kujtuar aventurën te "Djajtë e kuq". Ai u shpreh se karriera e tij do të kishte një ecuri tjetër, nëse Mojes do vazhdonte ta drejtonte Mançesterin. Januzaj pranon se me ardhjen e Van Gal te Mançester Juanjtid, karriera e tij filloi të merrte për poshtë, prandaj u detyrua të largohej nga "Djajtë". "Van Gal nuk më la shumë hapësira për të menduar se mund të kisha të ardhme aty. Isha i ri dhe si i tillë, trajneri duhej të më linte të luaja i qetë dhe të më besonte. Fatkeqësisht, Van Gal nuk e bëri këtë, duke ma vështirësuar shumë sezonin. Ndryshe isha me David Mojesin, pasi ai më besoi që në fillim dhe më jepte mundësi të luaja. E kuptova që me ardhjen e Van Galit karriera ime nuk po progresonte më, kuptova që ai ma "vrau" karrierën. Jam në një moshë të re dhe besoj se kam ende shumë për të dhënë", - ka thënë Janzuaj. Andan Januzaj u kërkua për shumë kohë nga Kombëtarja kuqezi, madje vetë tifozët ishin ata që morën një nismë, por që u anashkalua nga futbollisti, i cili zgjodhi Belgjikën. Aktualisht, 23-vjeçari aktivizohet me ekipin e Real Sociedadit në Spanjë.

SPANJË

Barcelona fal Xhironën dhe rihap kampionatin

Barcelona nuk ka arritur të marrë më shumë se një barazim përballë Getafes ditën e sotme. Ekipi i Valverede duket se po kursen energjitë për "Champions League", teksa ka zhvilluar një ndeshje zhgënjyese përpara tifozëve të saj. Pjesa e parë ishte nga ato që rrallë herë i ndodhin katalanasve. Asnjë gjuajtje në portë nga ana e tyre, teksa edhe Getafe nuk ka lënë shumë hapësira në fushë. Në pjesën e dytë, Barcelona ka kërkuar të bëjë diçka ndryshe, por goditjet janë ndalur nga portieri Guaita, i cili ishte në një super formë ndeshjen e sotme. Hera e fundit që Barcelona është ndalur në shtëpi, ka ndodhur në dhjetorin e 2017 përballë Selta Vigos. Barcelona kryeson e vetme kampionatin spanjoll, me 7 pikë më shumë se Atletikoja e vendit të dytë, kur kanë mbetur edhe 15 ndeshje. Më herët Sevija ka mundur në shtëpi m e rezultatin 1-0 Xhironën.

ANGLI

Junajtid ngec në Njukastëll dhe lan duart me titullin

Surpriza e kësaj javë në kampionatin anglez, ka qenë fitorja e ekipit të Njukastëllit përballë milionave të Junajtid. Ndeshja e luajtur në "St James Park", është mbyllur me rezultatin 1-0 në favor të ekipit të Benitezit. Në minutën e 65-të, Riçi ka shënuar për vendasit, një gol që erdhi pas një aksioni model. Ekipi i Mançester Junajtid e ka kërkuar me ngulm golin gjatë gjithë ndeshjes, por mbrojtja dhe forma e shkëlqyer e portierit bardhezi e mohuan në të gjitha rastet. Mundësin më të mirë për të barazuar e kishte Martial, i cili vetëm pak metra larg portës, nuk arriti të finalizonte. Ekipi i "djajve të kuq" nuk i ka ndalur për asnjë moment të vetëm aksionet sulmuese, por në fund largohet pa asnjë pikë nga stadiumi i Njukastëll. Me këtë humbje që pësoi Mançester Junajtid, fitues dolën "kushërinjtë" e Sitit të cilët e shohin veten 16 pikë larg. Juanjtid mban vendin e dytë dhe mesa duket, gara në kampionatin anglez do të jetë vetëm për zonën e Europës, pasi titulli është rezervuar nga Siti.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Një kapanon helikopteri.
6. Janë diletantët.
13. Janë të përjetsëhm të tillë në arktik.
14. Ekstreme në duel.
16. Duhen respektuar në kohë.
17. Eshtë skuadra.
19. Morsa pa kufij.
21. Fillojnë nazet.
22. Roje pa re.
23. Duhet të jetë reciprok një i tillë.
25. Një është edhe Dajti.
26. Pineda e Garcia Lorca-s.
27. Banushi që qe komik i yni
28. Kanë feçkë të gjatë.
29. Inicialet e Harris aktor.
30. Eshtë dëshirë fikse.
32. Gjysma e laikut.
34. Inicialet e Moravia-s.
36. Ndryshon çdo ditë.
37. Parajsa e humbur.
39. Kroger i Thomas Mann.
41. Janë kapo.
43. Mbyllin komentin.
44. Ka një shpejtësi fantastike.
48. Ekstreme në letër.
49. Një tis mjegulle.
51. Lindin në kokë
53. Ngrihet nga të ftohtit.
54. Nuk shuhej dot nga Tantali.
55. Eshtë vendi aderues.
56. Në hyrje të ambientit.

VERTIKAL
1. Në hyrje harkut.
2. Ishin grekët në Trojë.
3. Pjesëz mohuese.
4. Ka një qafë shumë të gjatë.
5. Inicialet e Duvall.
7. Fshehin fytyrat.
8. Inicialet e Fogazzaro-s.
9. Gjysmë tandem.
10. Mbyllin teatrot.
11. Shkroi Një jetë e Jezusit.
12. Eshtë edhe ai i metrit.
15. Janë vegla për ngarkim.
18. I fundit ai i Bernardo Bertolucci-t
20. Emri i Magritte
22. Janë të dhënat jo zyrtare.
24. Eshtë enë bakri.
25. Gustav kompozitor.
26. Një pjesë e memorialit.
27. Mbyllin koncerte.
31. Mbyllet me dorezë.
23. Nicholas, bomber te Chelsea.
35. Claude-Oscar pilot
38. Kufizojnë detyrat.
40. Fillojnë ideologjinë.
42. Një mjet transporti publik.
45. Rubinstein që qe balerinë.
46. Dhejtë angleze.
47. Matet pa kufij.
50. Janë të ndryshme në leje.
52. Hapet në fund.
53. Ekstreme në janar.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Në mes të Edgar dhe Poe.
6. Lourdes i portugezëve.
12. Emri i parë i Fassbinder.
14. Janë edhe ato të fytyrës
15. Kuron pa zë.
16. Ishte komandanti si Çerçiz Topulli.
18. Në kokë të çdo njeriu.
19. Shuhet me pak ujë.
20. Janë ujëvarat.
22. Pak teatrale.
23. William teniste.
24. Diftong në kuotë.
25. Në fund majtas.
26. Janë besimtarë.
27. Rrallë është përgjysmë.
29. Hayworth që qe aktore
31. Eshtë si vegël.
32. Eshtë ajka e shoqërisë.
34. Akoma është ndryshe.
36. Janë katër në violinë.
38. Fillojnë llogarinë.
40. Ndryshe për latinët.
41. Agjencia evropiane e hapësirës.
42. Shuhet me pak ujë.
44. Në krye të komandës.
45. Një zakon i keq.
46. Merret në bankë.
48. Një pjesë e perëndimit.
49. Një ndjekës i një filozofi
50. Të parat në ambient.
51. Sampras i tenisit.

VERTIKAL
1. Inkasojnë para.
2. Tregohet një me kuotë.
3. Ruhet me dietë.
4. Fillojnë andej.
5. Këndon Laura non c'é.
6. Do të bëhen pemë.
7. Mund të jetë fotografik.
8. Filmi i parë shqiptar.
9. Inicialet e Reitman.
10. Xhemali që qe bariton.
11. Në atë vend.
13. Mund të jenë balistike.
14. Si të gjithë.
17. Një klasë si një tjetër.
21. Eshtë i ndarë në Sure.
23. Fillojnë sefte.
26. Një fjalë gratis.
28. Janë efektet e padëshiruara të ndërmarrjes.
30. Eshtë halli.
33. Ishulli i Odiseut.
34. Tase e volejbollit.
35. Kishin mbret Decebalin.
37. Mund të jenë edhe gjaku.
39. Atomike ajo e Salvador Dalí.
40. Bajat pa ekstreme.
43. Roth aktor
45. Në fillim të vitit.
47. Inicialet e Redford.
48. Fillojnë periudhën.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

1		9		7	3	6		
7	8	4	2					
	5			4		2		9
			1	6			3	
8	6						2	1
	3			8	5			
4		6		5			1	
					9	3	4	7
		2	7	1		5		8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigjje e sudokut të numrit të kaluar

7	6	9	8	3	1	2	4	5
1	4	2	5	7	9	3	6	8
8	3	5	4	2	6	1	9	7
5	8	6	2	9	7	4	3	1
9	7	1	6	4	3	8	5	2
4	2	3	1	5	8	6	7	9
6	1	4	9	8	5	7	2	3
2	9	7	3	1	4	5	8	6
3	5	8	7	6	2	9	1	4

Argëtim filozofik

- Eshtë më mirë t'i meritoni nderet dhe të mos i gëzoni ato, se sa t'i gëzoni dhe të mos i meritoni.
(Mark Tueni)

- Askush nuk është nderuar ndonjëherë për atë që ka marrë. Nderimi ka qenë për atë që ai ka dhënë.
(Kelvin Tuejxh)

- Kur keni filluar të mos jepni më kontribut, keni filluar të vdisni.
(Eleanor Rusvelt)

KRIPTOSKEME



KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

R	O	M	A	N	C	I	E	R	E	T				C
I	R	O	N		L				T	R	U	P		
T		R		T	A	R	T	A	R	E	T			
	K	A	M	E	R	I	E	R	E	T				U
D	E	L	I	R	A	N	T	E	T			P	R	
C			T	A	B	O	R		A	T	A			
	K	R	I	P	E		A			O	L	E		
S	L	O		I	L	P		R	A	U	L			
T	A	N	T	A	L	I		U	R	R	A			
U	S		R		E	K	I	P	I		T	E		
F	A	T	A	L		A	L	I	E	N	E	T		
E	T	A	P	A	T		K	A	T	E	T	I		

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALEKRYQI (1)

FJALEKRYQI (2)

Argëtim filozofik

Thënie të mençura

- Njeriu i zgjuar sheh aq sa duhet, jo aq sa mundet. **(Montanj)**
- Nuk ka rëndësi ku dhe si keni jetuar. E rëndësishme është çfarë keni bërë aty ku keni qenë.
(Xhorxha O'kife)
- Nuk ka gra të parrezistueshme; ka vetëm burra që nuk dinë të rrezistojnë. **(Anonim)**
- Për të arritur gjetjen e thelbit tonë të vërtetë, duhet që më parë të jetojmë te të shtatë mëkatet.
- Udhëtari, nëse nuk takon një shoqërues më të mirë ose të ngjashëm me veten, vazhdon i bindur vetëm: nuk bëhet shoqëri me budallain.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!

GSH
www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!